www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 27

Tiranë – E premte, 27 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 18.2.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 834, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin".....	1267
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 136, datë 18.2.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2015 në njësitë e qeverisjes qendrore".....	1267
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 137, datë 18.2.2015	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të pronës nr. 1119, me emërtim "Skuadrilja, vendstrehim, (ish-regjimentit 4020)", me vendndodhje në Fushë-Prezë, Rinas, Tiranë dhe të pronave nr. 1120, me emërtim "Grup Depo Logjistike-Teknike, (ish-regjimentit 4020)", nr. 1121, me emërtim "ish-ekonomi ndihmëse, NBU, (ish-regjimentit 4020)", nr. 1122, me emërtim "Ish-bateri AKA, Radiodrita, (ish-regjimentit 4020)", me vendndodhje në Rinas, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	1268
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 18.2.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e bordit drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit".....	1270
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 139, datë 18.2.2015	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Picari", sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Reparti i axhusterisë me Tetojën dhe Reparti i instrumenteve, në "Albpetrol" sh.a., Patos".....	1271

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 140, datë 18.2.2015	Për miratimin e rregullores "Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar".....	1271
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 141, datë 18.2.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 424, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", të ndryshuar.....	1273
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 18.2.2015	Për përcaktimin e rregullave për lëshimin e autorizimit të ministrit të Shëndetësisë për importimin e barnave pa autorizim për tregtim..	1275
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.2.2015	Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave....	1277
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 18.2.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura, në qytetin e Korçës.....	1278
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 18.2.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të mjediseve të ish-godinës së Ministrisë së Mjedisit.....	1280
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 18.2.2015	Për miratimin e dokumentit të politikave për implementimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e portalit të të dhënave të hapura.....	1280
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 149, datë 18.2.2015	Për pagat e punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.....	1299
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 18.2.2015	Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.....	1301

VENDIM
Nr. 135, datë 18.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 834, DATË 18.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2, e kreut II, të vendimit nr. 834, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Përgatit dokumente apo mendime vlerësuese për projektaktet e propozuara për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, bashkërendon punën për përgatitjen dhe paraqitjen e projektakteve që propozohen nga Kryeministri apo institucionet e pavarura. Bashkërendon, nëse nevojitet, veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, ministrive apo autoriteteve shtetërore përgjegjëse me institucionet e pavarura.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 136, datë 18.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2015 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 1 064 veta ...".

2. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas ndarjes "(21) Shërbimi Informativ Shtetëror" shtohet ndarja "(22) Ministria e Kulturës", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në ndarjet "(3) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes", "(6) Ministria e Drejtësisë", "(18) Institucione të tjera" dhe "(20) Ministria e Zhvillimit Urban" shtohen nënndarjet, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Në ndarjen 11, (Ministria e Punëve të Brendshme), periudha kohore "mars-maj", zëvendësohet me "shkurt-prill".

ç) Në ndarjen 15, (Avokati i Popullit), koha mesatare ditore e punës "4 orë/ditë", zëvendësohet me "6 orë/ditë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
(22) Ministria e Kulturës	34			
Aparati	1	Sanitar	6 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Aparati	2	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Galeria Kombëtare e Arteve	3	Vëzhgues salle	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Teatri Kombëtar	1	Punëtor mirëmbajtje	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Teatri Kombëtar	1	Mjeshtër butaforist	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Qendra Kulturore për Fëmije	1	Punëtor mirëmbajtje	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Cirku Kombëtar	1	Teknik i mesëm (rrobaqepës)	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Cirku Kombëtar	1	Teknik i mesëm (marangoz)	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Cirku Kombëtar	1	Sanitar	6 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Cirku Kombëtar	1	Veteriner	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Cirku Kombëtar	1	Punëtor mirëmbajtje	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Muzeu Historik Kombëtar	3	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Muzeu Historik Kombëtar	1	Sanitar	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Muzeu Historik Kombëtar	1	Punëtor mirëmbajtje	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
ZAK Butrint	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	Maj - Tetor
ZAK Butrint	3	Punëtor mirëmbajtje	6 orë/ditë	Maj - Tetor
ZAK Parku Arkeologjik Apoloni	3	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	Maj - Tetor
ZAK Parku Arkeologjik Bylis	1	Punëtor mirëmbajtje	6 orë/ditë	Maj - Tetor
Muzeu i Artit Mesjetar Korçë	1	Restaurator	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
QRV Artit	5	Restaurator	4 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
(3)Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	1			
ATRAKO	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
(6) Ministria e Drejtësisë	2			
Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
Komiteti Shqiptar i Biresimeve	1	Punonjës informacioni	6 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
(18)Agjencia Telegrafike Shqiptare	4			
Agjencia Telegrafike Shqiptare	4	Specialist	6 orë/ditë	Shkurt - Dhjetor
(20)Ministria e Zhvillimit Urban	100			
Drejtoritë rajonale të ALUIZNI-t	74	Specialist	8 orë / ditë	Mars-dhjetor
Drejtoritë rajonale të ALUIZNI-t	26	Teknik	8 orë / ditë	Mars-dhjetor

VENDIM
Nr. 137, datë 18.2.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TË PRONËS NR. 1119, ME EMËRTIM "SKUADRILJA, VENDSTREHIM, (ISH-REGJIMENTIT 4020)", ME VENDNDODHJE NË FUSHË-PREZË, RINAS, TIRANË DHE TË PRONAVE NR. 1120, ME EMËRTIM "GRUP DEPO LOGJISTIKE-TEKNIKE, (ISH-REGJIMENTIT 4020)", NR. 1121, ME EMËRTIM "ISH-EKONOMI NDIHMËSE, NBU, (ISH-REGJIMENTIT 4020)", NR. 1122, ME EMËRTIM "ISH-BATERI AKA, RADIODRITA, (ISH-REGJIMENTIT 4020)", ME VENDNDODHJE NË RINAS, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të pronës nr. 1119, me emërtim "Skuadrilja, vendstrehim (ish-regjimentit 4020)", me vendndodhje në Fushë-Prezë, Rinas, Tiranë, dhe të pronave nr. 1120, me emërtim "Grup depo Logjistike-Teknike, (ish-regjimentit 4020)", nr. 1121, me emërtim "Ish-ekonomi ndihmëse, NBU, (ish-regjimentit 4020)", nr. 1122, me emërtim "Ish-Bateri AKA, Radiodrita, (ish-regjimentit 4020)", me vendndodhje në Rinas, Tiranë, sipas formularëve standard të inventarizimit të pronave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t'i përdorur për qëllime investimesh nga kompani të interesuara.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së

Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet prona nr. 1119, me emërtim "Skuadrilja, vendstrehim, (ish-regjimentit 4020)", me vendndodhje në Fushë-Prezë, Rinas, Tiranë dhe pronat me nr. 1120, me emërtim "Grup depo Logjistike-Teknike, (ish-regjimentit 4020)", nr. 1121, me emërtim "Ish-ekonomi ndihmëse, NBU, (ish-regjimentit 4020)", nr. 1122, me emërtim "Ish-Bateri AKA, Radiodrita, (ish-regjimentit 4020)", me vendndodhje në Rinas, Tiranë.

3. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave, të përcakuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

	A		B				C			
Nr	Zona Kadast Indeksi i hartes	Numëri pasuris	Emërtesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e Pronës në M2 ose MI	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me Përgjegjësi Administrative	Enti Përdorues Statusi Juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1118			**Ofiçinë Riparimi, Vendstrehim (Ish Regjimentit 4020)**		**Fushë Prezë Rinas Tiranë**	**103204 M2**	Për Mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes KFA Reparti Usht.Nr.3001	KFA Rep.Usht. Nr.3300	Identifikuar me të dhën e formularit standart dh të planvendosjes, të dërguar nga KFA me Nr.3453, datë 07.09.20 dhe Nr.3453/1, datë 17.09.2010
				Ofiçina e Avionëve		1900				
				Strehim për 3 Aviona		550				
				Strehim për 3 Aviona		550				
				Strehim për 3 Aviona		550				
				Strehim për 3 Aviona		550				
1119			**Skuadrilja, Vendstrehim (Ish Regjimentit 4020)**		**Fushë Prezë Rinas Tiranë**	**89370 M2**	Për Mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes KFA Reparti Usht.Nr.3001	KFA Rep.Usht. Nr.3300	Identifikuar me të dhën e formularit standart d të planvendosjes, të dërguar nga KFA me Nr.3453, datë 07.09.20 dhe Nr.3453/1, datë 17.09.2010
				Vend strehim Avionësh (tynel)		130				
				Vend strehim Avionësh (tynel)		130				
				Vend strehim Avionësh (tynel)		130				
				Vend strehim Avionësh (tynel)		130				
				Vend strehim Avionësh (tynel)		130				
				Vend strehim Avionësh (tynel)		130				
				Vend strehim Avionësh (tynel)		390				
				Vend strehim Avionësh (tynel)		390				
				VK skuadrilje		0				Shkatërruar
				Depo Munic.		0				Shkatërruar
				Depo Munic.		0				Shkatërruar
				VK Fjetinë mencë klasë		0				Shkatërruar
				Truall		87810				

1121			Ish Ekonomi Ndihmëse, NBU (Ish Regjimentit 4020)		Rinas, Tiranë	23376.2 M2	Për Mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes KFA Reparti Usht.Nr.3001	KFA Rep.Usht. Nr.3300	Identifikuar me të dhënat e formularit standart dhe të planvendosjes, të dërguar nga KFA me Nr.3453, datë 07.09.2010 dhe Nr.3453/1, datë 17.09.2010
				Objekti Nr.1 Godinë 1 kate		234				
				Objekti Nr.2 Godinë 1 kate		194.6				
				Objekti Nr.3		352				
				Godinë 1 kate						
				Objekti Nr.4 Godinë 1 kate		364				
				Kabinë elektrike		0				Shkatërruar
				Truall		22231.6				
1122			Ish Bateri AKA, Radiodrita (Ish Regjimentit 4020)		Rinas, Tiranë	4053.7 M2	Për Mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes KFA Reparti Usht.Nr.3001	KFA Rep.Usht. Nr.3300	Identifikuar me të dhëna e formularit standart dhe të planvendosjes, të dërguar nga KFA me Nr.3453, datë 07.09.2010 dhe Nr.3453/1, datë 17.09.2010
				Objekti Nr.1 Godinë 2 kate		151.2				Zënë për banim
				Objekti Nr.2 Godinë		73.6				" "
				Stallë derrash		0				Shkatërruar
				Magazinë		0				Shkatërruar
				Garazhd Auto		0				Shkatërruar
				Kullë		0				Shkatërruar
				Truall		3828.9				

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

	A		B				C			
Nr	Zona Kadast Indeksi i hartes	Numëri pasuris	Emërtesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e Pronës në M2 ose Ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me Përgjegjësi Administrative	Enti Përdorues Statusi Juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1120			Grup Depo Logjistike-Teknike, (Ish Regjimentit 4020)		Rinas, Tiranë	123468 m²	Për Mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes Rep.Ushtr. Nr.3001 (KFA)	Reparti Ushtarak Nr.3400 Rinas	- Identifikuar me të dhënat formularit standart dhe të planvendosjes dërguar me shkresën e KFA Nr. 1133, datë 02.04.2013
				Truall		123468				

VENDIM
Nr. 138, datë 18.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 433, DATË 5.5.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, "Për standardizimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 433, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"a) 2 (dy) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;

b) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën;

c) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë.".

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 139, datë 18.2.2015

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "PICARI", SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË "REPARTI I AXHUSTERISË ME TETOJËN DHE REPARTI I INSTRUMENTEVE, NË "ALBPETROL" SHA, PATOS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Picari", sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Reparti i axhusterisë me Tetojën dhe Reparti i instrumenteve", në "Albpetrol", sh.a., Patos, me sipërfaqe të përgjithshme 9 800 (nëntë mijë e tetëqind) m^2, nga ku 3 364 (tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) m^2 sipërfaqe nën ndërtesë.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 140, datë 18.2.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 29, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT PARAUNIVERISITAR

Neni 1
Objekti i rregullores

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (KKAP), krijimi i të cilit mbështetet në nenin 29 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në rregulloren "Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar".

2. Rregullorja "Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar" ka për objekt organizimin dhe funksionimin e Këshillit.

3. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar mund të përgatisë edhe rregullore për kordinimin e veprimtarive të përcaktuara në këtë rregullore, por brenda kompetencave dhe fushave të veprimtarisë së tij.

4. Emërtimi i shkurtuar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar i përdorur në këtë rregullore është "Këshilli".

Neni 2

Roli, përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit

Roli, përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit parashikohen në ligjin "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

Neni 3

Mandati i anëtarëve të Këshillit dhe zëvendësimi i tyre

1. Anëtarët e Këshillit, personalitete të njohura për kontribute në fushën e arsimit, zgjidhen me mandat 4-vjeçar. Pagesa e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, i dalë për këtë qëllim.

2. Mandati i anëtarit të Këshillit mbaron përpara afatit:

a) për shkaqe natyrore;

b) për shkaqe ligjore, kur humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate, apo dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë;

c) kur jep dorëheqjen.

3. Mandati i anëtarit të zgjedhur të Këshillit ndërpritet kur nuk merr pjesë në të paktën tri mbledhje radhazi të KKAP-së, të organizuara gjatë një viti.

4. Anëtari i Këshillit, të cilit i është ndërprerë mandati apo i ka mbaruar përpara afatit, zëvendësohet me kandidatin që ka rezultuar me më shumë pikë në procedurën e konkurrimit.

5. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e anëtarit të larguar.

Neni 4

Sekretariati i Këshillit

1. Këshilli mbështetet nga sekretariati i tij, i cili koordinon veprimtarinë e Këshillit me atë të Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar.

2. Sekretariati i Këshillit përbëhet nga zëvendësministri që mbulon arsimin parauniversitar në MAS, i cili koordinon punën e sekretariatit, drejtori i Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar dhe një ose dy sekretarë, të cilët janë punonjës në MAS.

3. Sekretariati i Këshillit:

a) i paraqet me shkrim ministrit propozimet e parashtruara në mbledhjet e Këshillit;

b) përpunon propozimet në mbledhjen e Këshillit në formën për ekzekutim dhe ia paraqet ministrit;

c) mban procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit, përgatit materialet që do t'u shpërndahen anëtarëve të Këshillit, mban korrespondencën dhe kryen shërbime të tjera të kësaj natyre.

4. Në fund të çdo viti kalendarik, sekretariati depoziton në arkivin e MAS-it një dosje me mbishkrimin "Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar", që përmban urdhrat përkatës të ministrit, procesverbalet e mbledhjeve, punimet e grupeve të punës dhe materiale të tjera të paraqitura në mbledhjet e Këshillit.

5. Përbërja nominative e sekretariatit të Këshillit dhe detyra të tjera të tij caktohen me urdhër të ministrit të MAS-it.

Neni 5

Organizimi i mbledhjeve të Këshillit

1. Këshilli mblidhet mbi bazën e një kalendari në datën e caktuar nga ministri.

2. Një mbledhje e Këshillit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij.

3. Mbledhja e Këshillit dhe rendi i ditës u njoftohen anëtarëve të Këshillit prej sekretariatit të paktën dhjetë ditë para datës së mbledhjes. Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, rendin e ditës dhe materialet mbështetëse, të cilat u dërgohen anëtarëve të Këshillit në formë të shkruar apo elektronike.

4. Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren me kërkesën e ministrit ose me kërkesën me shkrim të së paktës 1/3 e anëtarëve të Këshillit.

5. Nëse mbledhja e jashtëzakonshme thirret, duke mos respektuar përcaktimet e pikës 3 të këtij neni, por anëtarët janë të pranishëm dhe bien dakord ta pranojnë thirrjen e mbledhjes të vlefshme, atëherë ajo mund të vazhdojë rregullisht.

6. Në mbledhjet e Këshillit ftohen rregullisht të marrin pjesë përfaqësues të njësive arsimore vendore.

Neni 6
Rendi i ditës i mbledhjeve të Këshillit

1. Rendi i ditës i një mbledhjeje të Këshillit përcaktohet nga ministri me nismën e tij.

2. Në rendin e ditës së një mbledhjeje të Këshillit përfshihet një çështje që propozohet nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit.

3. Në fillim të një mbledhjeje të Këshillit, mund të shtohet një çështje në rendin e ditës:

a) me kërkesë të ministrit;

b) me propozim të një ose disa anëtarëve të Këshillit, kur miratohet nga shumica e anëtarëve të Këshillit të pranishëm në mbledhje.

Kur trajtimi i një çështjeje shtesë kërkon parapërgatitje, mbledhja shtyhet me 24 orë.

Neni 7
Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje të Këshillit mbahet procesverbali që pasqyron të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes.

2. Anëtari i Këshillit ka të drejtë që të kërkojë që procesverbalit t'i bashkëngjitet një deklarim me shkrim për mendimet që ka dhënë gjatë mbledhjes dhe t'i plotësohet kjo kërkesë.

3. Anëtari i Këshillit ka të drejtë të kërkojë që të lexojë procesverbalin e mbledhjes ose të mbledhjeve paraardhëse dhe t'i plotësohet kjo kërkesë.

4. Procesverbali nënshkruhet nga çdo anëtar pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse të Këshillit.

Neni 8
Grupet e punës

1. Për trajtimin e çështjeve të veçanta ngrihen grupe pune, ku marrin pjesë deri në tre ekspertë të jashtëm dhe një ose dy anëtarë të Këshillit.

2. Grupet e punës ngrihen me urdhër të ministrit dhe janë të përkohshme.

3. Një grup pune ngrihet me kërkesën e ministrit ose të shumicës së anëtarëve të Këshillit.

4. Grupi i punës paraqet para Këshillit punimin e shkruar, të përgatitur prej tij.

5. Punimi, i përgatitur nga grupi i punës, ruhet në arkivin e Këshillit.

Neni 9
Informimi publik

Në faqen elektronike zyrtare të MAS-it hapet një rubrikë e posaçme për veprimtarinë e Këshillit.

VENDIM
Nr. 141, datë 18.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 424, DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 60, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit i Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, të miratuar me vendimin nr. 424, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë tekstin e rregullores emërtimi "Ministria e Arsimit dhe Shkencës" zëvendësohet me "ministria përgjegjëse për arsimin" dhe emërtimi "ministri i Arsimit dhe Shkencës" zëvendësohet me "ministri përgjegjës për arsimin".

2. Pika 1, e nenit 5, të rregullores, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në shërbim të politikave të arsimit të lartë ministria përgjegjëse për arsimin mund të kërkojë vlerësimin e jashtëm të cilësisë së institucioneve dhe programeve të studimit nga agjenci të tjera vlerësimi, që janë anëtare me të drejta të plota të Rrjetit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ose të Regjistrit Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (EQAR). Vlerësimi i jashtëm nga këto agjenci kryhet me qëllim akreditimin, rating-un ose

renking-un e programit/programeve të studimit apo të institucionit të arsimit të lartë. Vlerësimi i jashtëm nga këto agjenci kryhet në përputhje edhe me standardet e procedurat vendase për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.".

3. Në fund të pikës 1, të nenit 9, të rregullores, shtohet kjo fjali:

"Nëse njëri nga anëtarët ekspert i huaj, zgjidhet kryetar i Këshillit të Akreditimit, ai paguhet me 20% mbi tarifën e anëtarit, ekspert i huaj.".

4. Pika 2, e nenit 9/1, të rregullores, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Ekspertët e huaj, anëtarë të grupeve të vlerësimit të jashtëm, paguhen me 700 (shtatëqind) euro për çdo ditë pune, por jo më shumë se 8 (tetë) ditë për vlerësimin institucional dhe jo më shumë se 4 (katër) për programet e studimit. Ekspertëve të huaj u mbulohen edhe shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, për çdo vlerësim të kryer, por jo për më shumë se 5 (pesë) ditë për vlerësimin institucional dhe jo më shumë se 3 (tre) ditë për programet e studimit.".

5. Në nenin 14 të rregullores shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

"4. Të ardhurat për shërbimet e kryera nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë transferohen nga një vit financiar në tjetrin, vetëm për vlerën që derdhet në buxhetin e Agjencisë, përfshirë të ardhurat e krijuara deri në vitin 2014.".

6. Tabelat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur rregullores, zëvendësohen me tabelat nr. 1.1 dhe nr. 2.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1.1

PAGESA E EKSPERTËVE VENDAS PËR VLERËSIMIN PARAPRAK TË PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË IAL-SË

Nr.	Lloji i programit të studimit	Pagesa e ekspertit vendas
1	Vlerësimi paraprak i programit të studimit dyvjeçar jouniversitar	11.300 lekë
2	Vlerësimi paraprak i programit të studimit të ciklit të parë:	15.000 lekë
3	Vlerësimi paraprak i programit të studimit të ciklit të dytë: a) Master profesional b) Master i shkencave c) Master i shkencave (program i integruar 5/-6 vjeçar)	 18.000 lekë 20.000 lekë 25.000 lekë
4	Vlerësimi paraprak i programit të studimit të ciklit të tretë: a) Doktoratë b) Specializim afatgjatë	 30.000 lekë 25.000 lekë

Tabela nr. 2.1

PAGESA E EKSPERTËVE VENDAS PËR VLERËSIMIN E JASHTËM DHE AKREDITIMIN E IAL-SË

Nr.	Lloji i vlerësimit	Pagesa e ekspertit vendas
1.	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i institucionit të arsimit të lartë. a) Një institucion me 1-2 fakultete b) Një institucion me 3-5 fakultete c) Një institucion me më shumë se 5 fakultete c) Kolegj, filial	 120.000 lekë 150.000 lekë 200.000 lekë 100.000 lekë
2.	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i programit të studimit dyvjeçar jouniversitar	55.000 lekë
3.	Vlerësimi i riogranizimit të programit të studimit	50% e pagesës së ekspertit për çdo cikël studimi
4.	Vlerësimi i plotësimit të kushteve për vlerësimin paraprak përfundimtar apo për akreditimin përfundimtar pozitiv.	30% e tarifës për vlerësimin paraprak /vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e një Institucioni ose programi studimi.
5.	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i programit të studimit të ciklit të parë: a) Bachelor	85.000 lekë
	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i programit të studimit të ciklit të dytë: a) Master profesional b) Master i shkencave c) Master i shkencave (program i integruar 5/-6 vjeçar)	 90.000 lekë 100.000 lekë 120.000 lekë
	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i programit të studimit të ciklit të tretë: a) Doktoratë b) Specializim afatgjatë	 130.000 lekë 100.000 lekë

VENDIM
Nr. 142, datë 18.2.2015

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT TË MINISTRIT TË SHËNDETËSISË PËR IMPORTIMIN E BARNAVE PA AUTORIZIM PËR TREGTIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 33, pika 2, të ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor) për barna, të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, i cili ka autorizim për tregtim nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, ministri i Shëndetësisë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

2. Kërkesa për autorizim importi, për çdo bar të paregjistruar, paraqitet pranë Ministrisë së Shëndetësisë nga subjektet e licencuara për import barnash.

Në kërkesën për autorizim importi për barna pa autorizim për tregtim nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore duhet të përcaktohen:

a) principi aktiv;
b) emri tregtar i barit;
c) forma dhe doza farmaceutike;
ç) sasia, seria;
d) data e skadencës;
dh) çmimi për njësi i barit;
e) emri dhe adresa e mbajtësit të autorizimit për hedhjen në treg të barit dhe/ose firma prodhuese;
ë) indikacionet terapeutike të barit;
f) lloji i përdorimit të barit (spitalor apo ambulator), si dhe arsyet e pajisjes me autorizim importi;
g) dogana kufitare.

Bashkëlidhur kërkesës për autorizim importi, subjekti i licencuar për import barnash duhet të ketë edhe vërtetimin e lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, nëpërmjet të cilit vërtetohet nëse bari është i pajisur ose jo me autorizim tregtimi.

3. Autorizimi për import jepet vetëm për barnat për të cilat nuk është lëshuar autorizim për tregtim nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

4. Autorizimi për import është i vlefshëm për një periudhë dymujore, nga data e lëshimit të tij. Pajisja me autorizim importi kryhet kundrejt një tarife të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit të Financave. Të ardhurat nga këto tarifa derdhen në buxhetin e shtetit.

5. Njësia përgjegjëse për farmaceutikën, në Ministrinë e Shëndetësisë, përpara propozimit për lëshimin e autorizimit për import, ka të drejtën të verifikojë dokumentacionin e paraqitur nga subjekti importues, pranë autoriteteve apo subjekteve private ose publike, nga ku ato janë lëshuar.

6. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, përpara fillimit të procedurës së zhdoganimit për barin përkatës, kërkon nga subjekti importues, përveç autorizimit të ministrit të Shëndetësisë për importimin e barnave pa autorizim tregtimi, sipas pikës 2, të këtij vendimi, edhe këto dokumente në origjinal:

a) Faturën e barit;

b) Listën e paketimit;

c) Certifikatën e analizave për çdo seri të barit;

ç) Certifikatën e origjinës së barit.

7. Dokumentacioni i përmendur në pikën 6, të këtij vendimi, ruhet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", të ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore njofton me shkresë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo procedurë.

8. Barnat pa autorizim tregtimi, të pajisura me autorizim importi, pasi zhdoganohen sipas rregullave në fuqi, pajisen me pullën e kontrollit nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas procedurës së parashikuar në ligjin nr. 105/2014, datë 31.7.2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik".

9. Të gjitha autorizimet e importit të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë publikohen në faqen zyrtare të kësaj ministrie ose në buletinet përkatëse farmaceutike, brenda një afati tetëditor nga momenti i lëshimit të tyre.

10. Formati i autorizimit për importin e barnave pa autorizim për tregtim, që lëshon ministri, do të jetë sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Vendimi nr. 24, datë 22.1.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për lëshimin e autorizimit të ministrit të Shëndetësisë për importimin e barnave pa autorizim për tregtim", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI

AUTORIZIM IMPORTIMI

Nr. _____, datë _____

Mbështetur në ligjin nr. 105/2014, datë 31.07.2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", neni 11, pika 2 dhe neni 33, pika 1, autorizohet ***"....." sh.p.k.*** - Tiranë, me administrator ***z/znj (drejtuesi teknik),*** të importojë barin e paautorizuar (tre artikuj, një artikull me dy seri) nga firma ***"Emri i kompanisë"*** (shteti prej nga vijnë barnat), si më poshtë:

Nr.	Emri i barit	Lënda vepruese	Formë/ doza	Sasia	Seria	Skad.	Çmimi
1.							
2.							
3.							

Autorizimi është i vlefshëm për një importim dhe me afat prej 2 (dy) muajsh.

MINISTRI

VENDIM
Nr. 143, datë 18.2.2015

PËR PËRCAKTIMIN E MARZHEVE TË TREGTIMIT DHE FABRIKIMIT TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 105/2014, datë 31.7.2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çmimi maksimal i prodhimit të barnave nga fabrikuesit vendas caktohet duke shtuar 20 (njëzet) për qind mbi koston e fabrikimit.

2. Çmimi maksimal i tregtimit me shumicë të barnave nga importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë caktohet duke shtuar 11 (njëmbëdhjetë) për qind mbi çmimin CIF të importit të barit dhe të EXW të prodhimit vendas, e konvertuar në lekë sipas kursit mesatar të njoftuar nga Banka e Shqipërisë, për çdo 6-mujor. Marzhi 11 (njëmbëdhjetë) për qind ndahet ndërmjet importuesit dhe shpërndarësit, përkatësisht, 8 (tetë) për qind dhe 3 (tre) për qind.

3. Çmimi maksimal i tregtimit me pakicë të barnave caktohet duke shtuar 25 (njëzet e pesë) për qind mbi çmimin e blerjes nga shpërndarësi farmaceutik.

4. Për barnat e listës, që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, zbatohen marzhe të diferencuara, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Për barnat që blihen nga institucionet shëndetësore publike, çmimi maksimal i tregtimit dhe marzhi i fitimit, që do të zbatohen mbi çmimin CIF ose EXW, do të jetë sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për barnat që nuk janë përfshirë në listën bashkëlidhur do të zbatohet një marzh fitimi 8 (tetë) për qind.

6. Vendimi nr. 53, datë 5.2.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave", shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA NR. 1
TABELA E GRUPEVE TË BARNAVE PËR PËRDORIM NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË VEND DHE MARZHET E FITIMIT QË DO TË ZBATOHEN MBI ÇMIMIN CIF OSE EXW TË TYRE

GRUPI I
PËR GRUPIN E MËPOSHTËM TË BARNAVE DO TË ZBATOHET NJË MARZH FITIMI 8 (TETË) PËR QIND.

1. Anestezi reanimacion
2. Dermatology ike
3. Hormonale
4. Organeve sensoriale
5. Metabolizmi dhe trakti tretës
6. Psikiatri
7. Sistemi kardiovaskular
8. Sistemi muskolo-skelektik
9. Sistemi nervor
10. Sistemi respirator

GRUPI II
PËR GRUPIN E MËPOSHTËM TË BARNAVE DO TË ZBATOHET NJË MARZH FITIMI 6 (GJASHTË) PËR QIND.

1. Antiinfektive
2. Gjaku dhe organet formuese të gjakut
3. Citostatike

VENDIM
Nr. 145, datë 18.2.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA, NË QYTETIN E KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura, në qytetin e Korçës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime", sh.a., Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë "arë" dhe "truall", me sipërfaqe të përgjithshme 62 491.7 m^2, në vlerën 28 944 862 (njëzet e tetë milionë e nëntëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, nga të cilat:

a) tokë "arë", me sipërfaqe 62 122.7 m^2, me vlerë 25 880 317 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë;

b) tokë "truall", me sipërfaqe 369 m^2, me vlerë 3 064 545 (tre milionë e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për tokë "arë" dhe "truall", prej 28 944 862 (njëzet e tetë milionë e nëntëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, zëri "Kosto lokale".

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga shoqëria "Ujësjellës Kanalizime", sh.a., Korçë.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar ZVRPP", të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime", sh.a., Korçë.

8. "Ujësjellës Kanalizime", sh.a., Korçë të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, në bashkëpunim me "Ujësjellës Kanalizime", sh.a., Korçë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga "Ujësjellës Kanalizime", sh.a., Korçë dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, "Ujësjellës Kanalizime", sh.a., Korçë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
SEKTORI SHPRONESIMEVE
UJESJELLES KANALIZIME KORCE

Lista e pronarëve qe preken nga ndertimi Impiantit te Trajtimit te ujrave të përdorura Korçë

Nr.	PRONARI			Zona Kadast.	Nr. i pasurisë	Sip.truall m^2	Çmimi (lekë/ m^2)	Vlera (në lekë)	Sipërfaqe Arë (m^2)	Çmimi njesi (leke/m^2) m^2	Vlera (në lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Sotiraq	Vani	Bicolli	8561	24/46				9000	416.6	3,749,400	Konfirmim ZRPP
2	Bujar	Meleq	Feçanji	8561	24/45				3000	416.6	1,249,800	Pa çertif. pronesie, Çertif. e pron. nuk eshte leshuar pasi nuk ka ardhur konfirmim nga KVVTP
3	Hasan	Sali	Ramollari	8561	24/44				3000	416.6	1,249,800	Konfirmim ZRPP
4	Irfete	Zeqir	Unaza	8561	24/43				4000	416.6	1,666,400	Konfirmim ZRPP
5	Marjana	Postol	Gjinko	8561	24/42				1000	416.6	416,600	Konfirmim ZRPP
6	Roland	Dhori	Mizaku	8561	24/41				4500	416.6	1,874,700	Konfirmim ZRPP
7	Stavri	Spiro	Dede	8561	24/40				5640	416.6	2,349,624	Konfirmim ZRPP
8	Enver	Muharem	Take	8561	24/39				6000	416.6	2,499,600	Konfirmim ZRPP
9	Sybi	Muharem	Take	8561	24/38				5764.0	416.6	2,401,282	Konfirmim ZRPP
10	Venetike	Sybi	Qeraxhi	8561	24/37				5.7	416.6	2,375	Konfirmim ZRPP
11	Pellumb	Hamit	Nako	8561	24/36				624	416.6	259,958	Konfirmim ZRPP
12	Ramadan	Muharem	Lipo	8561	24/35				1750	416.6	729,050	Konfirmim ZRPP
13	Fredi	Muhamet	Stringa	8561	24/34				3055	416.6	1,272,713	Konfirmim ZRPP
14	Sofia	Niko	Hoxhalli	8561	24/33				2066	416.6	860,696	Konfirmim ZRPP
15	Valter	Refat	Myrteza	8561	24/32				11406	416.6	4,751,740	Konfirmim ZRPP
16	Sabrie	Nexhip	Dishnica	8561	24/31				1312.0	416.6	546,579	Konfirmim ZRPP
17	Perikli		Polena	8562	8/105	369	8.305	3 064 545				
SIPËRFAQE E SHPRONËSIMIT						369			62122.7			Sip tot. 62491.7
Vlerat totale e Shpronësimit								**3 064 545**			**25,880,317**	**Vlera tot. 28 944 862**

VENDIM
Nr. 146, datë 18.2.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË TË MJEDISEVE TË ISH-GODINËS SË MINISTRISË SË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të mjediseve të ish-godinës së Ministrisë së Mjedisit, për mjedise pune, për zhvillimin normal të veprimtarisë administrative të këtij institucioni.

2. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 147, datë 18.2.2015

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PËR IMPLEMENTIMIN E TË DHËNAVE TË HAPURA PUBLIKE DHE KRIJIMIN E PORTALIT TË TË DHËNAVE TË HAPURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikave për implementimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e portalit të të dhënave të hapura, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

DRAFT POLITIKA
PËR IMPLEMENTIMIN E TË DHËNAVE TË HAPURA
NË ZBATIM TË PLANIT TË VEPRIMIT TË OGP-SË

HYRJE

Qeveria shqiptare është e angazhuar për të punuar për një qeverisje më të mirë, cilësore, të hapur dhe transparente. Programi i qeverisë 2013-2017 ka përcaktuar si prioritet rritjen e transparencës dhe përmirësimin e shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës *Open Government Partnership*.

Implementimi i të dhënave të hapura dhe krijimi i portalit qeveritar për të dhënat e hapura është një angazhim i rëndësishëm i qeverisë, pjesë e planit të veprimit të hartuar në kuadër të iniciativës globale për *Open Government Partnership* (OGP). Përmes krijimit të portalit qeveritar për të dhënat e hapura, synohet përmirësimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë së administratës publike dhe njëkohësisht të gjenerohet më shumë vlerë ekonomike dhe sociale.

Politikat për zhvillimin e të dhënave të hapura kanë marrë një zhvillim të shpejtë në pesë vitet e fundit në vende të ndryshme. Iniciativat për realizimin e *open data* janë të formave të ndryshme në vende të ndryshme duke filluar nga zhvillimet e portaleve e të dhënave të veçanta në kuadër të zhvillimit të e-qeverisjes drejt projekteve më ambicioze për të pasur realisht "*open data*".

Transparenca është një nga tre prioritet kyçe të përcaktuara së fundmi nga udhëheqësit e

vendeve të G8. Ata nënshkruan në qershor 2013 disa parime të specifikuara për *Open Data* në dokumentin *Open Data Charter*. Të dhënat e hapura mbështetin dhe inkurajojnë inovacionin dhe sigurojnë një përgjegjshmëri më të madhe për përmirësimin e demokracisë.

Bashkimi Europian ka adoptuar disa dokumente për implementimin e *open data* dhe ka krijuar portalin për të dhëna të hapura në nivel BE-je. Shumë vende kanë adoptuar planet e veprimit dhe politikat kombëtare për realizimin e të dhënave të hapura.

Të dhënat janë të fuqishme. Ato ndikojnë në transparencë dhe ndihmojnë në kontrollin e saktë të çdo aktiviteti. Shumë vende kanë nisur programe transparence ndaj qeverive dhe zyrave publike nëpërmjet publikimit të të dhënave "*Open Data*" në internet.

Dokumenti i politikave për të dhëna të hapura është hartuar mbështetur në praktikat e mira të zhvilluara nga vendet e tjera dhe parimet ndërkombëtare të pranuara për zhvillimin e të dhënave të hapura.

Ky dokument përcakton vizionin e qeverisë shqiptare, parimet dhe objektivat kryesore për të dhëna të hapura, hapat dhe aktivitetet që do ndërmerren për realizimin e këtij angazhimi dhe krijimin e portalit qeveritar për të dhëna të hapura. Gjithashtu dokumenti përcakton institucionet përgjegjëse për implementimin dhe monitorimin e realizimit të të dhënave të hapura.

KAPITULLI I PARË
ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Rregullimi ligjor për të dhënat e hapura

E drejta e informimit si një ndër të drejtat themelore të njeriut është e rregulluar me dispozita të posaçme në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë[1], ku përcaktohen parimet dhe i garantohet qytetarëve e drejta për informim. Brenda fushëveprimit të saj, në nenin 232, ka një referencë të drejtpërdrejtë në konceptin e përgjithshëm që i garanton shtetasve të Republikës së Shqipërisë të drejtën për informim, të drejtën për të marrë informacion të prodhuar ose të poseduar nga organet shtetërore apo nga persona që ushtrojnë funksione shtetërore.

E drejta informimit e lidhur ngushtësisht me funksionimin e administratës publike, gjen rregullim edhe në Kodin e Procedurave Administrative (KPA). Kodi i Procedurës Administrative si ligj bazë procedural për veprimtarinë administrative, parashikon në nenin 20 parimin themelor mbi të drejtën për t'u informuar në procesin administrativ. Gjithashtu, KPA në kreun II- E drejta për t'u informuar (nenet 51-55) mirëpërcaktuar dhe garanton gjerësisht këtë të drejtë.

Këto rregullime janë plotësuar edhe me ligjin nr. 119/2014 datë 18.9.2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen më të drejtën e informimit. Ligji nr. 119/2014 datë 18.9.2014 "Për të drejtën e informimit" është një ligj shumë i rëndësishëm, ku në nenit 3 të tij parashikon se "Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik pa u detyruar të shpjegojë motivet". Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Gjithashtu çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Neni 4 i këtij ligji garanton të drejtën e qytetarëve për të marrë informacion edhe pa kërkesë të qytetarëve nga organet publike. Konkretisht ligji parashikon se: "Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni", duke theksuar që autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut,

[1] *Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Populllor; miratuar me referendum më 22.11.1998; shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007; ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008; ndryshuar me ligjin nr. 88/2012 (datë 18.9.2012)*

[2] *E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.*

"garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik" dhe sidomos "vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion".

Neni 2 i këtij ligji e përkufizon në mënyrë të qartë se informacioni publik "është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht

nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Pra, informacionet që përbëjnë objektin e ligjit "Për të drejtën e informimit" janë ato të dhëna sipas përkufizimit të nenit 2 të tij.

Gjithashtu neni 7 i ligjit 119/2014 parashikon kategoritë e informacioneve që duhet të bëhen publike nga autoritetet publike pa kërkesë të të interesuarve.

Ky nen parashikon:

Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota:

i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

ii) të ligjeve;

iii) të akteve nënligjore;

iv) të kodeve të sjelljes;

v) të çdo dokumenti politikash;

vi)të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit-/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:

i) listën e kontratave të lidhura;

ii) shumën e kontraktuar;

iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;

iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e doku-

mentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.".

Legjislacioni për lirinë e informimit, në kushtet ideale, duhet të udhëhiqet nga parimi për dhënien maksimale të informacionit. Parimi për dhënien maksimale të informacionit prezumon që i gjithë informacioni që disponohet nga organet publike duhet të jepet dhe që ky prezumim mund të shpërfillet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.

Ligji për të drejtën e informimit është një nga ligjet bazë për shoqërinë e informacionit që rregullon të drejtën dhe lirinë për akses në informacionin/dokumentet e mbajtura nga autoritetet publike.

Bashkimi Europian ka adoptuar direktivën për ripërdorimin e dokumenteve/informa-cionit publike 2003/98/EC e ndryshuar[3] në vitin 2013. Kjo direktivë është transpozuar në 9 vende të BE-së si pjesë integrale e ligjeve përkatëse për të drejtën e informimit dhe nga 13 shtete Anëtare kanë zgjedhur të adoptojnë masa specifike ligjore për të traspozuar këtë direktivë.

Recitali 8 i kësaj direktive thotë që është i nevojshëm një kuadër i përgjithshëm për kushtet e ripërdorimit të dokumenteve të sektorit publik me qëllim sigurimin e kushteve të ndershme jodiskriminuese dhe proporcionale të ripërdorimit të këtij informacioni. Sektori publik mbledh, prodhon, riprodhon dhe shpërndan dokumente në përmbushje të detyrave publike. Përdorimi i këtyre dokumenteve për të tjera arsye përbën një "ripërdorim".

Bashkimi Europian e shikon këtë direktivë si një direktivë kuadër të lidhur me implementimin e *open data*.

E parë lidhur me procesin e integrimit në BE, legjislacioni vendas për shoqërinë e informacionit sipas nenit 103 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) duhet të përafrohet gradualisht me *acquis* përkatëse të BE-së.

Gjithashtu neni 105 "Informacioni dhe komunikimi" i MSA-së përcakton se Komuniteti dhe Shqipëria do të marrin masat e nevojshme për të nxitur shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit. Përparësi do t'u jepet programeve që synojnë dhënien e informacionit bazë lidhur me Komunitetin për publikun e gjerë dhe dhënies së informacioneve më të specializuara për rrethet profesionale në Shqipëri.

Në këtë kuadër është e nevojshme të analizohet dhe shikohet mundësia e adoptimit të direktivës 2003/98/EC në legjislacionin vendas.

Në aspektin teknik për realizimin e të dhënave të hapura, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit ka hartuar rregulloren "Për standardet e publikimit të të dhënave në formatin *Open Data*", e cila përcakton kërkesat teknike për të dhënat e hapura dhe formatin e rekomanduar për këtë qëllim në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Është e nevojshme që këto standarde për publikimin e të dhënave në formatin *open data* të njihen dhe zbatohen në një shkallë sa më të gjerë.

Situata aktuale në ofrimin e të dhënave të hapura për publikun.

Bazuar në praktikat ndërkombëtare, ofrimi i të dhënave të hapura lidhet me të dhëna në disa fusha të rëndësishme që mund të grupohen si më poshtë:

[3] *Direktiva 2013/37/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013 e cila amendon direktivën 2003/98/EC mbi përdorimin e informa-cionit në sektorin publik*

Të dhënat kryesore të grupuara sipas tri drejtimeve:

GRUPI I TË DHËNAVE TË PËRGJEGJSHMËRISË	GRUPI I TË DHËNAVE ME IMPAKT SOCIAL	GRUPI I TË DHËNAVE INOVATORE
Të dhëna qendrore të mbajtura nga qeveria dhe korporatat për të dhënë llogari	Të dhëna të përdorura në planifikim, shpërndarje dhe kritikat ndaj politikave sociale dhe me potencial në mbështetjen e një përfshirje më të madhe të qytetarëve	Të dhëna zakonisht të përdorura në aplikacionet e të dhënave të hapura nga ndërmarrjet ose me vlerë të lartë për biznesin
Legjislacioni	Performanca e sektorit të shëndetësisë	Hartat
Rezultatet e zgjedhjeve	Të dhëna për performancën e arsimit	Të dhënat për transportin publik
Të dhëna të detajuara për buxhetin	fillor dhe nëntëvjeçar (primar/sekondar)	Statistika të krimit
Të dhëna të detajuara për shpenzimet qeveritare	Statistika për mjedisin në vend	Të dhëna për tregtinë ndërkombëtare
Regjistri i biznesit	Të dhëna të detajuara për CENSUS-in	
	Të dhëna për pronësinë mbi tokën	

Është e qartë se këto të dhëna shtrihen në shumë fusha, sektorë dhe përgjegjësia për gjenerimin dhe publikimin e tyre është e shpërndarë në shumë institucione. Rritja e transparencës dhe ofrimi i të dhënave të hapura lidhet gjithashtu me krijimin e portaleve dhe ofrimin e të dhënave përmes faqeve zyrtare.

Në kuadrin e zhvillimit të *e*-qeverisjes janë ngritur dhe funksionojnë në vendin tonë disa portale. Gjithashtu ka një prezencë në rritje të institucioneve publike me faqet e tyre zyrtare të internetit.

Më poshtë japim një analizë të situatës aktuale për portalet kryesore të ofrimit të informacionit dhe të dhënave sipas grupimit të tyre më sipër.

SITUATA PËR GRUPIN E TË DHË-NAVE TË PËRGJEGJSHMËRISË

Publikimi i të dhënave për legjislacionin në www.qbz.gov.al

Publikimi i legjislacionit bëhet nga Qendra e Botimeve Zyrtare përmes faqes zyrtare www.qbz.gov.al.

Ndërkohë, informimi mbi legjislacionin, por dhe i projektakteve është një praktikë që haset shpesh në faqet zyrtare të institucioneve. Por jo në çdo rast ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe jo i standardizuar.

Për informimin dhe rritjen e pjesëmarrjes në procesin e konsultimit të akteve u krijua regjistri i legjislacionit të biznesit www.rlb.gov.al. Por aktualisht ky regjistër nuk është i përditësuar.

Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", në nenin 7 të tij parashikon krijimin e një regjistri elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Në këtë regjistër do të publikohen projektaktet për konsultim dhe do të shërbeje si një pikë qendrore konsultimi.

Të dhënat për rezultatet e zgjedhjeve

Të dhënat për rezultatet e zgjedhjeve janë të publikuara dhe të hapura në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve http://www.cec.org.al.

Në këtë faqe janë publikuar rezultatet e zgjedhjeve për Kuvendin dhe për zgjedhjet lokale.

KQZ publikon gjithashtu në faqen e saj zyrtare, të dhëna mbi financimin e partive politike në bazë të auditimit dhe monitorimi të partive politike nga KQZ, që kryhet përgjatë çdo viti kalendarik, si dhe përgjatë fushatës zgjedhore në zbatim të fushës së saj së veprimtarisë.

Këto të dhëna ofrohen në format PDF dhe Exel nga KQZ dhe janë të aksesueshme për qytetarët.

Të dhëna të detajuara për buxhetin

Në faqen e Ministrisë së Financave www.financa.gov.al është i publikuar ligji për buxhetin dhe të dhënat e detajuara për buxhetin vjetor. Këto të dhëna janë të publikuara në këtë faqe në format PDF.

Të dhëna të detajuara për shpenzimet qeveritare

Në zbatim të angazhimit të marrë në kuadër të OGP-së, Ministria e Financës filloi gjatë vitit 2013 publikimin e të dhënave për shpenzimet.

Të dhënat ishin në *microsoft exel* dhe jepnin pagesat ditore të përpunuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit që mbulon periudhën 30 janar 2012 deri në 11 korrik 2013. Publikimi i këtyre të dhënave ka pasur një bllokim pas kësaj periudhe dhe shumë prej dosjeve të të dhënave ishin të korruptuara.

Dilte e nevojshme të implementoheshin standardet teknike në të dhënat e hapura për këtë grup shumë të rëndësishëm të të dhënave.

Aktualisht është duke u punuar për përmirësimin e modulit të shpenzimeve dhe publikimin e tyre në formatin dhe standardin e duhur. Moduli i shpenzimeve është i publikuar dhe i hapur për publikun. Ky modul do të aksesohet nga *e*-government portali *e*-Albania dhe faqet zyrtare të institucioneve respektive.

Për implementimin e këtij moduli në të gjitha ministritë e linjës do të bashkëpunohet me çdo ministri për të dhënat që do të publikohen nëpërmjet këtij moduli.

Regjistri i biznesit

Mbështetur në nenin 61 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", QKR-ja kryen publikimin e të dhënave të regjistrit tregtar në buletin brenda një dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qartë data, në të cilën është regjistruar e dhëna e publikuar.

Regjistri i biznesit mbahet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Ky regjistër është i hapur dhe publikohet në www.qkr.gov.al.

Publikimi në Buletinin e Regjistrimeve Zyrtare përbën njoftim zyrtar të regjistrimeve, të kryera në kuptim të nenit 21 të ligjit për QKR-në. Regjistrimi gjeneron në kohë reale çdo të dhënë të regjistruar në regjistrin tregtar nga QKR-ja.

SITUATA PËR GRUPIN E TË DHË-NAVE ME IMPAKT SOCIAL

Shikojmë që të dhënat e grupuara me impakt social lidhen me të dhënat që publikon në një masë të madhe Instituti i Statistikave. Pjesë e objektivit për *Open Data* kanë qenë edhe të gjitha të dhënat e Institutit Kombëtar të Statistikave, INSTAT. Ky institucion duhet të standardizojë tërësisht procesin e publikimit të të dhënave statistikore të sektorit publik. Ky detyrim përkon edhe me direktivat e fundit të Komisionit Evropian për publikimin e të dhënave publike.

Publikimi i të dhënave statistikore në www.instat.gov.al

Aktualisht INSTAT vë në dispozicion për publikun dhe qytetarët informacion të gjerë dhe të dhëna[4] mbi shume fusha, si: arsimin, bujqësinë, buxhetin e familjes, çmimet, energjinë, informacionin ekonomik për ndërmarrjet, kulturën, mjedisin, ndërtimin, nivelin e jetesës, pagat dhe të ardhurat, popullsinë, regjistrin statistikor të ndërmarrjeve, shëndetin, sigurimet shoqërore dhe mbrojtjen sociale, shpenzimet e konsumit, statistikat financiare dhe bankare, transportin, tregtinë e jashtme, tregun e punës, turizmin etj.

Është e nevojshme të analizohet me detaje nëse të dhënat e publikuara nga INSTAT përfshijnë plotësisht dhe prezantojnë të dhënat e kërkuara për:

- Performancën e sektorit të shëndetësisë;
- Të dhëna për performancën e arsimit fillor dhe nëntëvjeçar (primar/sekondar);
- Statistika për mjedisin në vend;
- Të dhëna të detajuara për CENSUS-in;
- Të dhëna për pronësinë mbi tokën.

Gjithashtu INSTAT duhet të ofrojë të dhënat sipas standardeve ndërkombëtare për *open data* dhe në formatin e duhur për ripërdorim sipas përcaktimeve dhe në rregulloren e hartuar nga AKSHI. Kjo është pjesë edhe e angazhimeve të planit të veprimit të pare të OGP-së.

Informacion mbi situatën aktuale të *Open Data* në Institutin e Statistikave

Të gjitha të dhënat statistikore që INSTAT prodhon:

- janë të disponueshme në web në formatin excel;
- janë të disponueshme në struktura të lexueshme nga makina;
- janë pa pagesë;
- mund të aksesohen falë përdorimit të PC-AXIS software në formate "pa pronësi" (*non proprietary format*, p.sh. CSV);
- nuk publikohen nën një licencë të hapur për të mundësuar ripërdorim të lirë të të dhënave, duke përfshirë dhe ripërdorimin komercial;
- publikohen në kohë sipas kalendarit të publikimeve me përjashtim të rasteve kur ka vonesa në mbledhjen e informacionit në terren ose në sigurimin në kohë të informacionit nga burimet administrative;
- aksesi i tyre nuk është diskriminues;
- mungon një sistem i mirëfilltë i metadatës së të dhënave.

Fushat kryesore që INSTAT publikon të dhëna janë:

[4] www.instat.gov.al

- Arsimi;
- Bujqësia;
- Buxheti i familjes;
- Çmimet;
- Energjia;
- Informacioni ekonomik për ndërmarrjet;
- Kultura;
- Llogaritë kombëtare;
- Mjedisi;
- Ndërtimi;
- Niveli i jetesës;
- Pagat dhe kosto e punës;
- Popullsia;
- Postë-telekomunikacioni;
- Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve,
- Shëndeti, sigurimet shoqërore dhe mbrojtja sociale;
- Shpenzimet e konsumit dhe statistikat financiare dhe bankare;
- Të ardhurat e familjeve;
- Transporti;
- Tregtia e jashtme;
- Tregu i punës;
- Turizmi.

INSTAT është duke ndërtuar sistemin e metadatës për dokumentimin e të gjitha aktiviteteve statistikore. Ky sistem është projektuar për t'u integruar me faqen e webit të INSTAT-it, për të mundësuar shfaqjen e metadatave përkatëse për çdo tregues statistikor që publikohet. Projekti pritet të përfundojë gjatë vitit 2015.

Në website të INSTAT-it është vendosur "baza statistikore e të dhënave" në PC-AXIS, e cila mundëson navigimin në të dhëna dhe krijimin e tabelave output sipas nevojave të përdoruesve. Kjo bazë të dhënash krijon mundësinë që përdoruesi të aksesojë të dhënat statistikore në mënyrë dinamike dhe t'i shkarkojë ato në formate të ndryshme.

Gjithashtu INSTAT-i, në kuadër të Censusit të Popullsisë dhe Banesave ka krijuar aplikacionin webgis (www.instatgis.gov.al) i cili i mundëson përdoruesit visualizimin e të dhënave të Censusit në zona gjeografike të detajuara.

Ky sistem do të përdoret edhe për të dhënat e tjera statistikore që INSTAT-i prodhon për të mundësuar dallimet mes rajoneve me ndihmën e të dhënave statistikore. Shfaqja e të dhënave statistikore në harta është shumë e rëndësishme edhe për përdoruesit të cilët punojnë në fushën e zhvillimit rajonal për të mbështetur hartimin e politikave rajonale.

Në lidhje me popullimin e portalit www.opendata.gov.al me të dhënat statistikore të publikuara nga INSTAT-i, mendojmë që në fazën e parë të projektit të mundësohet vendosja e linkeve ku mund të gjenden të dhënat. Në një fazë të dytë të shikohet mundësia për krijimin e webservices për të mundësuar transferimin e të dhënave në kohë reale për të populluar portalin *open data.*

Në faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, në mënyrë periodike, jepen të dhëna për disa prej elementeve të mjedisit në formën e raportit të gjendjes së mjedisit vjetor.

Në faqen zyrtare të INSTAT-it jepen disa të dhëna për mjedisin, si:

- mbetjet e ngurta urbane dhe inerte 2003-2012;
- të dhëna fiziko kimike të ujërave në liqenet e Shqipërisë 2004-2010;
- pesticide të importuara gjatë 2005-2012;
- ndotja bakterologjike e ujit në plazhe 2010;
- cilësia e ujit të lumenjve 2012;
- importi i mbetjeve në vitin 2012;
- mjetet e transportit rrugor sipas llojit të karburantit në përdorim në 2013;
- pesticide të përdorura në bujqësi;
- përmbajtja e disa ndotësve atmosferikë në qytetet kryesore, cilësia e ajrit 2002-2012;
- cilësia e ujit të lumenjve 2012 etj.

SITUATA PËR GRUPIN E TË DHË-NAVE INOVATORE

Në këtë grupim praktika ndërkombëtare përfshin të dhënat për:

- Hartat;
- Të dhënat për transportin publik;
- Statistika të krimit.

Të dhëna për tregtinë ndërkombëtare

Statusi mbi të dhënat e hapura mbi hartat

Aktualisht nuk ka një infrastrukturë kombëtare të të dhënave gjeohapësinore. Krijimi i infrastrukturës kombëtare moderne të të dhënave gjeohapësinore NSDI me standarde evropiane, paraqitet si një domosdoshmëri, në kuadrin angazhimeve të qeverisë, në procesin e integrimit.

Në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës

kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë" është ngritur së fundmi Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG).

Ndër detyrat kryesore të ASIG është krijimi dhe administrimi i Gjeoportalit Kombëtar, duke garantuar akses të gjerë në të. Gjithashtu ASIG ka për detyrë bashkërendimin e aktivitetit të institucioneve të tjera që prodhojnë dhe përdorin gjeodata.

Për krijimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore (*National Spatial Data Infrastructure, NSDI*-së) po punohet me një projekt prej 1.2 milionë euro të mundësuar nga qeveria norvegjeze.

Ky projekt synon ndërtimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH-2010) si referencë e standardeve europiane për "GIS-in Kombëtar"; Ndërtimin e "Gjeoportalit Kombëtar", nëpërmjet të cilit do aksesohen të dhënat gjeohapësinore dhe shërbimet e lidhura me këto të dhëna.

Ndërkohë ekziston një portal i krijuar me nismën e Universitetit të Tiranës që ofron disa shërbime të lidhura me digjitalizimin e hartave, GIS, LIS http://gisalbania.com/index.htm.

Të dhënat për transportin publik

Të dhënat për transportin publik normalisht janë të kombinuara midis të dhënave në nivel qendror dhe atyre në nivel lokal.

Në faqen e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës publikohen raporte periodike në formatin pdf për sigurinë rrugore duke dhënë dhe të dhëna statistikore për këtë.

Është e nevojshme që këto të dhëna të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në faqen e INSTAT-it për transportin kanë disa të dhëna që përfshijnë mjetet e transportit në vite, numrin e aksidenteve në vite etj. Ndërkohë ka pak informacion në faqet e disa bashkive në lidhje me transportin publik që japin informacion mbi pikat e shitjeve të aboneve dhe planet për zhvillim në këtë fushë.

Të dhëna për statistika të krimit

Portali www.gjykata.gov.al është një portal i cili shërben për të ngarkuar të dhëna me interes për qytetarët, duke përfshirë edhe publikimin e vendimeve gjyqësore.

Ky portal lejon qytetarët që të shkarkojnë të dhëna, duke përfshirë edhe vendimet e gjykatës. Në kohën që shkruhen këto të dhëna shumë nga këto të dhëna dhe statistika janë të gatshme dhe të vlefshme edhe *on-line*. Megjithatë, me sa shihet edhe nga reagimet e qytetarëve, ka nevojë ende për me shumë punë për ta bërë promovimin e këtij angazhimi të OGP-së.

Ajo çka shihet si sfidë është bërja në mënyrë më shumë efektive të menaxhimit të burimeve publike.[5]

Lidhur me statistikat e krimit, në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme jepet informacion për statistikat e krimit në formën e "Buletinit Informativ" që është buletin mujor.

Po ashtu, në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, përmes Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, ofrohet në format PDF vjetari në vite lidhur me sistemin e drejtësisë[6], nëpërmjet të cilit jepet informacion mbi dinamikën e gjykimit të çështjeve nga gjykatat e ndryshme, tregohet mënyra e zhvillimit të proceseve gjyqësore, pasqyrohen në shifra veprimtarinë njëvjeçare të gjykatave të shkallës së parë, të gjykatave të apelit, të Gjykatës së Lartë, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit etj.

Të dhëna për tregtinë ndërkombëtare

Në lidhje me të dhënat për tregtinë ndërkombëtare ka informacione të publikuara në mënyrë periodike në raportet e Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Zhvillimit të Sipërmarrjes[7].

Këto të dhëna janë në format pdf dhe jepen si pjesë integrale e raporteve dhe analizave për zhvillimin ekonomik në tërësi. Është e nevojshme që këto të dhëna të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura.

Të dhëna të përgjithshme për tregtinë ndërkombëtare jepen dhe në raportet e INSTAT-it.

Në raportet që analizojnë situatën e publikimit të të dhënave në Shqipëri vërehet se në rastet kur të dhënat ofrohen, shpeshherë ato janë në format të papërshtatshëm dhe në të shumtën e rasteve këto të dhëna janë të ofruara në format të papërdorshëm në mënyre informative.

[5] www.gjykata.gov.al
[6] http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika
[7] http://www.ekonomia.gov.al/files/documents_files/14-04-03-09-35-57Newsletter_Shkurt_2014.pdf

Një tjetër problem i të dhënave të publikuara nga zyrat publike ka të bëjë me moskujdesin ndaj ruajtjes së të dhënave në kohë. Të dhënat publike zhduken periodikisht nga faqet web të zyrave publike për shkaqe nga më të ndryshmet.

Megjithëse aktualisht në Shqipëri janë standardizuar disa nga faqet e prezantuara në këtë analizë, të cilat bëjnë publike të dhënat për qytetarët dhe ofrojnë shërbime për ta, sërish ka nevojë për me tepër punë me qëllim që të jenë të harmonizuara me praktikat më të mira për të dhënat e hapura (*open data*). Standardet për publikimin e të dhënave në formatin *open data* të miratuara nga AKSHI janë pak të njohura dhe të zbatuara.

Në përfundim japim tabelën përmbledhëse me statusin aktual të publikimit të dhënave kryesore sipas grupimit ndërkombëtar për të dhënat e hapura.

Grupimi i të dhënave	Statusi aktual	Institucioni
Grupi i të dhënave të përgjegjshmërisë		
Legjislacioni	Të dhëna të hapura publikuar në format pdf, doc. www.qpz.gov.al Në këtë portal janë të publikuara aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara jo aktet e propozuara.	QPZ
Rezultatet e zgjedhjeve	Të dhëna të hapura të publikuara në www.cec.org.al	KQZ
Të dhëna të detajuara për buxhetin	Të dhëna të hapura të publikuara në www.financa.gov.al në format pdf.	Ministria e Financave
Të dhëna të detajuara për shpenzimet qeveritare	Në proces moduli i shpenzimeve.	Ministria e Financave/AKSHI
Regjistri i biznesit	Regjistri i biznesit është i hapur dhe publikohet në www.qkr.gov.al.	QKR
Grupi i të dhënave me impakt social		
Performanca e sektorit të shëndetësisë	Nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta. Nuk ka të dhëna për performancën e sektorit të shëndetësisë në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë e as në faqen zyrtare të INSTAT-it .	Ministria e Shëndetësisë, INSTAT
Të dhëna për performancën e arsimit fillor dhe nëntëvjeçar (primar/sekondar)	Nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta. Nuk ka të dhëna për performancën e arsimit fillor dhe nëntëvjeçar (primar/sekondar) në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit e as në faqen zyrtare të INSTAT-it	Ministria e Arsimit dhe Sportit, INSTAT
Statistika për mjedisin në vend	Në faqen zyrtare të INSTAT-it jepen disa të dhëna për mjedisin, si: Mbetjet e ngurta urbane dhe inerte 2003-2012 Të dhëna fiziko-kimike të ujërave në liqenet e Shqipërisë 2004-2010 Pesticide të importuara gjatë 2005-2012 Ndotja bakterologjike e ujit në plazhe 2010 Cilësia e ujit të lumenjve, 2012 Importi i mbetjeve në vitin 2012 Mjetet e transportit rrugor sipas llojit të karburantit të përdorur në 2013 Pesticide të përdorura në bujqësi Përmbajtja e disa ndotësve atmosferike në qytetet kryesore, cilësia e ajrit 2002-2012 Cilësia e ujit të lumenjve 2012 etj.	Ministria e Mjedisit, INSTAT
Të dhëna të detajuara për CENSUS-in	Të dhëna të hapura të publikuara format PDF	INSTAT
Të dhëna për pronësinë mbi	Nuk ka të dhëna të publikuara në faqen e ZRPP-së	ZRPP

tokën	në proces	
Grupi i të dhënave inovatore		
Hartat	Në proces, në faqen zyrtare të ASIG nuk rezulton asnjë e dhënë e unifikuar për hartat	ASIG
Të dhënat për transportin publik	Të dhëna pjesore në format PDF	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Statistika të krimit	Të dhëna pjesore. Lidhur me statistikat e krimit, në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme jepet informacion për statistikat e krimit në formën e "Buletinit Informativ" që është buletin mujor, si dhe nëpërmjet Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, ofrohet në format PDF vjetari në vite lidhur me sistemin e drejtësisë.	Gjykata, Ministria e Brendshme
Të dhëna për tregtinë ndërkombëtare	Të dhëna pjesore, periodike në format PDF	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

KRIJIMI I PORTALIT I TË DHËNAVE TË HAPURA

Krijimi i portalit të të dhënave të hapura ishte pjesë e Planveprimit të Parë Shqiptar në kuadër të OGP-së. Raporti Kombëtar i Vetëvlerësimit[8] publikuar me 18 tetor 2013, për statusin e realizimit të Planit të Parë të Veprimit të OGP-së 2011-2013, bën këtë vlerësim për ecurinë e këtij angazhimi të grupuar në angazhimet për rritje të transparencës:

2.1.1 TRANSPARENCA

Angazhimi	Përshkrimi	Etapat kryesore	Aktivitete
Portali i të dhënave në format të hapur	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit po krijon një portal qeveritar me të dhëna në format publik. Ky portal fillimisht do të përfshijë të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Thesarit për shpenzimet e përditshme nga të gjitha institucionet dhe agjencitë qendrore. E njëjta praktikë do të zbatohet për bazën e të dhënave të Autoritetit Postar Kombëtar dhe Komunikimeve Elektronike. Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT) do të zbatojë një strategji afatgjatë në format të hapur për bazën e saj të të dhënave. Si koordinatore kombëtare për mbledhjen e të dhënave mbi ekonominë dhe shoqërinë shqiptare, INSTAT-i do të standardizojë procesin e publikimit të të dhënave statistikore te sektorit publik në format të hapur. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit ka publikuar në mars 2013 një dokument të ri mbi Standardet Teknike të publikimit të të dhënave në format të hapur	Ky proces do të shtrihet në një shkallë më të gjerë dhe do të përfshijë të gjitha institucionet publike qendrore dhe agjencitë.	Krijimi i portalit të të dhënave publike.

[8] http://www.inovacioni.gov.al/al/legjislacioni/raporte

Sikurse është parashikuar dhe në planin e veprimit të OGP-së ky proces do të shtrihet në një shkallë më të gjerë dhe do të përfshijë të gjitha institucionet publike qendrore dhe agjencitë.

Ndërkohe nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është ngritur dhe funksionon portali www.e-albania.al. Portali *e*-Albania synon të shërbejë si një pikë e vetme e kontaktit për shërbime qeveritare. Portali *e* – Albania gjatë përmirësimit të aksesit të informacionit të përgjithshëm për publikun.

Nëpërmjet Portalit *e*-Albania publikohen informacione për 177 shërbime të ofruara nga administrata publike. Janë në proces rritje me mbi dyfish të numrit të shërbimeve informuese për qytetaret dhe biznesin.

Krahas shërbimeve informuese, në portal janë implementuar 11 shërbime elektronike (e-shërbimet) për qytetarët dhe bizneset.

Ofrimi i shërbimeve të informacionit për rregullimin ligjor për marrjen e një shërbimi, procedurat që duhet të ndiqen, formularët e aplikimit dhe kryerja e proceseve në rrugë elektronike që janë të ofruara nga www.e-albania.al, pa dyshim që shërbejnë në rritje të transparencës dhe luftën kundër korrupsionit. Së shpejti nga portali e-Albania do të aksesohet dhe moduli i shpenzimeve.

Por aktualisht portal www.e-albania.al është i fokusuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve elektronike dhe jo mirëfillta si një "*open data portal*".

Portali *Open Data* Albania

Aktualisht në vend me iniciativën e një OJQ-je, Instituti Shqiptar i Shkencave është ngritur një portal me formatin *open data*, që funksionon që nga viti 20109. Portali Open Data Albania është një portal i cili mbledh, përpunon dhe publikon në formate të ripërdorshme të dhëna nga disa zyra publike shqiptare. Projekti është një nismë teknike shkencore. Në këtë faqe publikohen vazhdimisht artikuj analitikë që mbulojnë fusha të ndryshme.

Në përfundim të analizës për situatën aktuale të publikimit të të dhënave të hapura sipas standardeve ndërkombëtare, në një konkluzion të përgjithshëm mund të themi se implementimi i *open data* është në hapat e parë. Për ta bërë realitet implementimin e të dhënave të hapura duhet kujdes dhe ndërmarrja e masave në dimensionin ligjor, politik, social, ekonomik, teknik, organizativ të të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të të dhënave.

Më konkretisht:

- Të dhënat e hapura (*open data*) janë shumë të rëndësishme për arsye se qytetari duhet që të jetë i informuar dhe të ketë në dispozicion të gjitha të dhënat

- Nga analiza e situatës aktuale shikohet që ofrimi i të dhënave të hapura edhe pse për një pjesë të të dhënave sipas standardeve ndërkombëtare është sot i mundur ai është i shpërndarë dhe jo i unifikuar dhe jo në standardet *open data*.

- Ofrimi i të dhënave është i shpërndarë në shumë site.

- Direktiva të BE-së për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nuk është adoptuar.

- Implementimi i *open data* kërkon përfshirje të gjerë të institucioneve qendrore dhe lokale.

- Krijimi i një portali open-data.gov.al do të lehtësonte aksesimin e të dhënave të hapura. Por realizimi i duhur i të dhënave të hapura në një portal për *open data* është më shumë se një proces teknik dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme për një portal.

- Portali për të dhënat e hapura duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e BE-së dhe të synojë ndërveprueshmërinë me portalin europian për *open data* si një e ardhme në procesin e integrimit europian.

- Koordinimi i duhur dhe përcaktimi i detyrave të çdo aktori është një faktor kyç në arritjen e suksesit në përmbushjen e kësaj detyre.

KAPITULLI II
VIZIONI DHE OBJEKTIVAT QË DO TË ARRIHEN

Qeveria shqiptare ka një agjendë ambicioze mbi reformën në të dhënat e hapura qeveritare. Qeveria shqiptare ka shprehur publikisht dhe ndërkombëtarisht angazhimin e saj ndaj Deklaratës së Hapur për Partneritet

[9] http://open.data.al

dhe rritjen e informacionit të disponueshëm në lidhje me aktivitetet e qeverisë, duke inkurajuar pjesëmarrjen e publikut dhe duke zbatuar standardet më të larta të integritetit në administratën publike dhe lehtësimin e aksesit në teknologjitë e reja.

Iniciativa për të Dhënat e Hapura Qeveritare shpreh një model ndryshimi që rikoncpeton efektivisht marrëdhënien ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe qytetarëve të saj. Të dhënat e hapura qeveritare përfshin një riorganizim dinamik të pushtetit të sektorit publik duke hequr dorë nga roli i tij si "mbajtës i informacionit" duke u ridimensionuar në një rol të ri atë të "ofrimit të informacionit".

Të dhënat e hapura qeveritare nënkupton ndryshim në perceptimin mbi informimin e publikut, duke sanksionuar si normë mbizotëruese, vënien në dispozicion për publikun e të dhënave të plota dhe jo selektive. Nga ana tjetër ndalimi i informacionit është një përjashtim dhe jo një rregull i përgjithshëm i kësaj politike.

Ndërkohë që vizioni i dëshirueshëm është që të dhënat e qeverisë të jenë të hapura, përjashtimet mund të lejohen vetëm në rastet për të respektuar dinjitetin, jetën private për individin dhe mbrojtjen e të dhënave individuale, si dhe në rastin e ruajtjes së sigurisë kombëtare.

Kjo iniciativë ka për qëllim promovimin e transparencës dhe llogaridhënies të institucioneve shqiptare ndaj qytetarëve. Është tashmë fakt i njohur botërisht se mungesa e transparencës inkurajon korrupsionin dhe inefiçencën. Përqasja ndaj të Dhënave të Hapura Qeveritare paraqet një ndryshim radikal nga një kulturë qeverisëse të mbyllur ndaj qytetarit në atë të transparencës.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj iniciative qeveria shqiptare ka për qëllim të promovojë rritjen ekonomike dhe zhvillim novator të teknologjive, promovimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse, si dhe promovimin e qeverisjes efiçente, duke respektuar dhe kontribuar rrjedhimisht në përmbushjen e parimeve bazë që shërbejnë për një demokraci cilësore, shtet të së drejtës funksional, politikë përfaqësimi transparente.

Ky dokument politikash përcakton parimet kryesore që do udhëheqin procesin për implementimin e të dhënave të hapura në Shqipëri bazuar në eksperiencën e vendeve të zhvilluara dhe parimet e miratuara në dokumentin e vendeve të *G8 Open Data Charter* në Qershor 2013:

- Të dhëna të hapura si parakusht/maksimalisht (*by default*);
- Të dhëna të hapura me cilësi dhe sasi;
- Të dhëna të hapura të përdorshme nga të gjithë;
- Publikimin e të dhënave në shërbim të përmirësimit të qeverisjes;
- Publikimin e të dhënave për inovacion.

Në përmbushje të programit të qeverisë dhe angazhimeve në kuadër të OGP-së, ky dokument përcakton këtë vizion:

"Një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme përmes ofrimit të të dhënave të hapura të standardizuara sipas praktikave më të mira ndërkombëtare."

Objektivat për realizimin e vizionit dhe parimeve kryesore të të dhënave të hapura

Gjatë periudhës 2014-2016 synohet të përmbushen këto objektiva:

Objektivi i parë: Përshtatja e kuadrit të duhur ligjor dhe mekanizmat e implementimit për të pasur një sistem efikas të të dhënave të hapura;

Objektivi i dytë: Krijimi i një portali unik për të dhënat e hapura: www.opendata.gov.al

Objektivi i tretë: Standardizimi dhe harmonizimi i të dhënave të hapura në nivel kombëtar, rajonal;

Objektivi i katërt: Arritja e një qeverisjeje transparente dhe të përgjegjshme nëpërmjet ofrimit të të dhënave të hapura.

Objektivi final është që në fund të periudhës 2014-2016 të kemi të dhëna të hapura, cilësore, të standardizuara, të besueshme dhe të ripërdorshme të publikuara në portalin www.opendata.gov.al për:

- Legjislacionin dhe projekt aktet ligjore;
- Mbi buxhetin dhe shpenzimet e qeverisë;
- Mbi statistikat;
- Mbi regjistrimin e biznesit;
- Mbi performancën e sistemit të edukimit;
- Mbi performancën e sistemit shëndetësor;

- Mbi pronësinë mbi tokën;
- Mbi statistikat e krimeve;
- Etj.

Lidhur me objektivin e parë sikurse analizohet dhe më lart Shqipëria aktualisht e ka të plotësuar kuadrin e saj ligjor nëpërmjet ligjeve, si: ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror", ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Ajo që del e nevojshme është adoptimi i direktivës 2003/98/EC "Për të drejtën e ripërdorimit të informacionit publik". Përshtatja e kuadrit të duhur ligjor për të pasur një sistem efikas të të dhënave të hapura dhe rregullat e zbatueshëm në rastin e ripërdorimit të informacionit publik do të ndihmonte që ky angazhim të plotësohej tërësisht.

Përsa i përket objektivit të dytë, krijimi i portalit *open data* është një nga angazhimet e marra si anëtare në iniciativën OGP. Qeveria Shqiptare është duke punuar dhe ka në proces këtë angazhim, për krijimin e portalit unik për të dhënat e hapura. Edhe pse sipas analizës së mësipërme që i bëmë portaleve ekzistente kemi një progres, duhet ende punë për krijimin e këtij portali për të dhënat e hapura. Aktivizimi i këtij portali do të plotësonte tërësisht angazhimin e marrë përsipër për *Open – Data* dhe koordinimin me të gjitha institucionet publike gjeneruese të të dhënave që duhet të jenë pjesë e portalit www.opendata.gov.al.

Standardizimi dhe harmonizimi i të dhënave të hapura duhet të bëhet në përputhje më standardet ndërkombëtare të *open data* në nivel kombëtar dhe rajonal. Për këtë arsye është bërë një analizë dhe janë marrë praktikat më të mira të vendeve të tjera lidhur me implementimin e *open data.*

Duhet shumë punë për të implementuar nga çdo institucion standardet e hapura për të dhënat e gjeneruara prej tyre.

Përsa i përket objektivit të katërt, arritja e një qeverisjeje transparente dhe të përgjegjshme do të realizohet nëpërmjet ofrimit të të dhënave të hapura dhe arritjes së të gjithë objektivave të mësipërm.

Me të dhëna të hapura do të kuptojmë që të dhëna të caktuara duhet të jenë të lira dhe në dispozicion për të gjithë për t'i përdorur dhe për t'i publikuar ato duke respektuar rregullimet për të drejtën e autorit, patentave apo mekanizmave të tjera të kontrollit.

KAPITULLI I TRETË
PROGRAMET QË DO TË NDIQEN

Për arritjen e objektivave të këtij dokumenti do të ndërmerren programet dhe aktivitetet si më poshtë:

Objektivi i parë: Përshtatja e kuadrit të duhur ligjor për të pasur një sistem efikas të të dhënave të hapura;

Angazhimet e Shqipërisë në fushën e shoqërisë së informacionit, rrjedhin nga neni 70 mbi përfarimin e legjislacionit si dhe neni 103 "Shoqëria e Informacionit"[10] të MSA-së. Aktualisht direktiva e BE-se për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nuk është adoptuar në legjislacionin shqiptar. Zbatimi i *open data* kërkon përshtatjen e legjislacionit të duhur për të dhënat e hapura në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e BE-së.

Në përmbushje të këtij objektivi do të punohet për adoptimin e direktivës së Bashkimit Europian 2003/98/EC për ripërdorimin e informacionit publik pas kryerjes së një analizë të kujdesshme të legjislacionit që rregullon të drejtën e informimit dhe publikimin e të dhënave.

Adoptimi i direktivës 2003/98/EC është parashikuar në Planin Kombëtar të Integrimit Europian që pritet të miratohet së shpejti. Aktor kryesor për këtë projekt do të jetë Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike si dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë se Informacionit.

[10] Bashkëpunimi do të përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit e për shoqërinë e informacionit. Ai do të mbështesë kryesisht orientimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Shqipërisë për këtë sektor me ato të Komunitetit. Palët do të bashkëpunojnë gjithashtu për të zhvilluar më tej shoqërinë e informacionit në Shqipëri. Objektivat globale do të përgatisin shoqërinë në tërësi për epokën digjitale, duke tërhequr investimet dhe duke siguruar aftësinë e rrjeteve dhe shërbimeve për përdorimin e informacionit.

Objektivi i dytë: Krijimi i një portali unik për të dhënat e hapura: www.opendata.gov.al

Krijimi i portalit www.opendata.gov.al, nuk nënkupton vetëm infrastrukturën teknike, por dhe popullimin e këtij portali me të dhëna cilësore, sasiore, të përdorshme nga të gjithë dhe sipas standardeve të formatit *open data*. Krijimi i portalit www.opendata.gov.al është padyshim një proces bashkëpunimi me një numër të madh aktorësh. AKSHI është ngarkuar për krijimin dhe administrimin e këtij portali. Ky angazhim vjen pas një eksperience të këtij institucioni për krijimin dhe administrimin e portalit www.e-albania.al. Krijimi i portalit www.opendata.gov.al. do shoqërohet me një sërë hapash dhe aktivitetesh të rëndësishme për identifikimin e të dhënave të rëndësishme që duhet të jenë pjesë e portalit:

Së pari është e nevojshme të njihet tërësia e të dhënave që institucionet publike mbajnë/gjenerojnë. Kjo është e rëndësishme dhe për të ndjekur përditësimin e tyre. Bazuar në eksperiencat e mira të vendeve të zhvilluara udhëzohet që procesi i operimit të *open data* portalit të ndjekë këtë rrugë:

- Identifikimi dhe mbajtja e një inventari të dhënash që mbahen/gjenerohen nga qeveria
- Prioritizimi i të dhënave që do përfshihen në portal duke u nisur nga të dhënat kryesore sipas tri nëngrupimeve bazuar në praktikën ndërkombëtare dhe duke vijuar me të dhëna të tjera me vlerë dhe impakt të lartë për shoqërinë
- Mbështetje dhe forcim kapacitetesh për institucionet që gjenerojnë të dhënat me qëllim standardizimin dhe implementimin e duhur të *open data*.

Suksesi i proceseve varet nga një numër faktorësh, si kooperimi i vazhdueshëm ndërmjet përdoruesve të portalit *open data* brenda dhe jashtë qeverisë, angazhimi në rritje për transparencë të sektorit publik dhe krijimi i një platforme adekuate për shpërndarjen e informacionit përmes: www.opendata.gov.al. Në disa raste të dhënat me interes për t'u përfshirë në portalin *open data* mungojnë dhe institucionet përkatëse duhet të fillojnë t'i mbledhin, krijojnë dhe përpunojnë këto të dhëna në formatin e duhur. Kjo do kërkojë një analizë dhe hartimin e një plani të detajuar nga institucioni/et përgjegjëse ku të përcaktohen hapat që do ndërmerren se dhe kur këto të dhëna do mundësohen për portalin.

Identifikimi i të dhënave që institucionet publike mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë është hapi i parë i rëndësishëm. Identifikimi i këtyre të dhënave, bazuar në faktin që ka një numër të madh institucionesh që përfshihen, përbën një sfidë jo të vogël.

Gjithashtu rritja e sasisë dhe cilësisë së të dhënave të prodhuara është një sfidë tjetër dhe një proces i vijueshëm. Publikimi i të dhënave të njësive vendore në portalin/linkun www.lokal.data.gov.al do ishte një sfidë në rritje. Për këtë arsye implementimi do bëhet me disa faza duke u nisur nga institucionet qendrore që janë përgjegjëse për grupin e të dhënave kryesore sipas praktikës ndërkombëtare.

Brenda tre muajve me miratimin e këtij dokumenti çdo ministri, institucionet e varësisë së tyre, si dhe institucionet e tjera përgjegjëse për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave që bëjnë pjesë në grupimet e të dhënave të hapura, do të identifikojnë listën e të dhënave të publikuara dhe të papublikuara që janë nën përgjegjësinë e fushës së tyre të veprimtarisë. Këto institucione do hartojnë dhe miratojnë rregulla për proceset e brendshme për identifikimin e të dhënave të papublikuara, duke informuar se kur ato janë krijuar dhe të informojnë që këto të dhëna të shtohen në inventarin e www.opendata.gov.al.

Çdo institucion do informojë Komitetin/Sekretariatin Teknik për këtë proces brenda tre muajsh nga miratimi i këtij dokumenti. Miratimi i të dhënave që do publikohen në *open data* portal do të bëhet nga Komiteti i Shërbimeve i ngarkuar për ndjekjen e implementimit të këtij dokumenti.

Paralelisht me këtë proces, institucionet publike duhet të zhvillojnë proceset e brendshme për mbështetjen e përditësimit të të dhënave të krijuara (ose kur është e përshtatshme të njoftojnë për ndërprerjen e tyre). Një proces i rëndësishëm i cili do ndihmojë institucionet në këtë proces është ai i marrjes së mendimit të përdoruesve të jashtëm të të dhënave. Për këtë në portalin e të

dhënave të hapura do ketë një rubrikë për dhënien e mendimit nga përdoruesit dhe çdo palë e interesuar. Në veçanti do të kërkohet identifikimi i të dhënave që nuk janë përfshirë në portal dhe që janë me interes për përdoruesit.

Prioritizimi i të dhënave që do përfshihen në portal – implementimi me faza

Krijimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i inventarit të të dhënave qeveritare do shoqërohet me procese që identifikojnë ato të dhëna të cilat janë më të rëndësishme për t'u përfshirë në portal që në fazat e para. Në të njëjtën kohë analiza dhe vlerësimi nëse bashkësia e të dhënave që do të jenë pjesë e portalit jep impaktin e dëshiruar dhe përfitimin e duhur të përdoruesve të këtyre të dhënave brenda dhe jashtë qeverisë, sa ato ndikojnë në rritje të transparencës, përgjegjshmërisë por jo vetëm.

Ministritë/institucionet do të ndërmarrin procese të vlerësimit për impaktin e publikimit të të dhënave përmes përfshirjes në këtë proces të grupeve të ndryshme të interesit, duke filluar gjashtë muaj nga miratimi i këtij dokumenti.

Qeveria do të punojë vazhdimisht me të gjitha institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe përdoruesit e të dhënave për përfshirjen e gjerë të përdoruesve në procesin e pasurimit dhe përmirësimit të të dhënave të hapura dhe inkurajimin e tyre për një vlerësimi të të dhënave. Do të zhvillohen të paktën çdo gjashtë muaj takime me palët e interesuara për këtë qëllim.

Në identifikimin e të dhënave që do të publikohen në portal është e rëndësishme gjithashtu të njihen përdorime të tjera të brendshme për të dhënat qeveritare përtej arsyes të parë të krijimit dhe mbledhjes së tyre, gjë që ka të bëjë me ripërdorimin e informacionit publik.

Prezantimi i portalit www.opendata.gov.al. Promovimi i portalit *open data* është shumë i rëndësishëm për të rritur impaktin nga publikimi dhe transparenca e të dhënave të rëndësishme. Aktivitete të ndryshme për promovimin e përdorimit të këtij portali dhe të dhënave të publikuara në të do të ndërmerren me krijimin dhe plotësimin e tij me të dhëna. Paralelisht me këto aktivitete do të bëhet promovimi i çdo hapi apo veprimi për bërjen të disponueshme të të dhënave sipas fazave. Kjo do të ndikojë në rritjen e përdorimit të këtij portali dhe shfrytëzimin e mundësive që të dhënat e hapura ofrojnë.

Transparenca është një nga tre prioritet kyçe të përcaktuara së fundmi nga G8. Udhëheqësit e vendeve të G8 nënshkruan një sërë rregullash/parimesh të specifikuara për *Open Data Charter*.

G8 ka identifikuar 14 fusha me vlerë të lartë që së bashku me të dhënat do të ndihmojnë në zhbllokimin e potencialit ekonomik për të dhënat e hapura, mbështetin dhe inkurajojnë inovacionin dhe sigurojnë një përgjegjshmëri më të madhe për përmirësimin e demokracisë. Në fushat e identifikuara janë:

- Të dhëna të vendndodhjes: të dhënat gjeohapësinore të cilat informojnë mbi hartat dhe planifikimin;
- Performanca dhe shpërndarja. Të dhënat të cilat tregojnë se sa efektive janë institucionet publike dhe shërbimet që ofrojnë në përmbushje të detyrave publike dhe shpërndarjen e politikave.
- Të dhënat financiare. Shpenzimet e qeverisë, të dhënat për prokurimet dhe kontratat, si dhe të dhënat për menaxhimin e financave publike.
- Operacionale. Të dhëna rreth strukturës operacionale, vendosja e pikave të ofrimit të shërbimeve publike dhe burimet e vlefshme brenda secilës prej tyre.

Mbështetja e institucioneve për zhvillimin dhe publikimin e të dhënave dhe forcimin e kapaciteteve. Implementimi i suksesshëm i këtij dokumenti kërkon padyshim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e aftësive dhe njohurive për *open data* dhe standardet e realizimit të *open data*. Vendet e zhvilluara kanë përcaktuar në *G8 Open Data Charter* si parim kryesor politikën për *open data "by default"*. Ne do të synojmë që ky parim gradualisht të implemetohet në të gjitha institucionet publike.

Për disa institucione implementimi do jetë një tranzicion jo i lehtë dhe në disa raste kërkon një analizë/konsideratë të detajuar me impakt me të gjerë në veçanti kur të dhënat

janë të rëndësishme, kur të dhënat janë aktualisht të lidhura me modelet e biznesit organizativ dhe të lidhura me të ardhurat ose kur të dhënat përmbajnë data që nuk janë në pronësi të qeverise sa janë kapacitetet dhe burimet në dispozicion për realizimin e tyre. Për rritjen e kapaciteteve institucionale do organizohet trajnime pranë ASPA në bashkëpunim me AKSHI dhe institucione të tjera që kanë zhvilluar praktika të mira të të dhënave të hapura. Do të organizohen seminare dhe aktivitete për rritjen e njohurive mbi standardet e formatit *open data* dhe njohjen e rregullores së miratuar nga AKSHI.

Për rritjen e kapaciteteve institucionale në zhvillimin e *open data* do të ndiqet periodikisht shkëmbimi i praktikave të mira mbi të dhënat e hapura. Ka tashmë disa modele të mira në rritje përmes institucioneve publike ku të dhënat janë publikuar si të dhëna të hapura. Përmes sekretariatit do punohet për të koordinuar aktivitetet me ministritë/institucionet dhe personat e kontaktit për shpërndarjen e praktikave të mira të të dhënave të hapura.

Sigurimi i të dhënave cilësore në portalin *open data*. Kur një e dhënë publikohet në portalin qeveritar ajo duhet të sigurojë cilësinë dhe saktësinë me të lartë. Gjithashtu që të dhënat të kenë impaktin e duhur tek përdoruesit ato duhet të publikohen në formatin dhe fjalorin e duhur për të qenë lehtësisht të kuptueshme dhe të thjeshta në përdorim. Çdo institucion që është ofrues i të dhënave do jetë përgjegjës për saktësinë dhe cilësinë e informacionit të ofruar në portal.

Institucionet do caktojnë një person përgjegjës për komunikim të vazhdueshëm me Sekretariatin teknik dhe administruesin e *open data portal*. Gjithashtu një person kontakti duhet të caktohet për t'iu përgjigjur nevojave të njerëzve që mundohen të përdorin të dhënat. Një tjetër person kontakti duhet të caktohet për t'iu përgjigjur ankesave për shkelje të parimeve.

Objektivi i tretë: Sigurimi i të dhënave në formatin *open data* sipas standardeve ndërkombëtare.

Për sigurimin e të dhënave në formatin *open data* sipas standardeve ndërkombëtare do të punohet me të gjitha institucionet për implementimin gradual brenda katër viteve të ardhshme të standardeve të mëposhtme për formatin *open data* të përcaktuara në rregulloren e AKSHI-t. Të dhënat konsiderohen "të hapura", nëse ato publikohen në mënyrë që të përputhen me parimet e mëposhtme:

- Të dhënat duhet të jenë të plota

Të gjitha të dhënat publike duhet të jenë të disponueshme. Të dhënat janë informacione të ruajtura elektronikisht, duke përfshirë por jo vetëm, dokumente, baza të dhënash, transkripte dhe regjistrime audio/vizuale. Të dhënat publike janë ato të dhëna, të cilat nuk janë subjekt vlerësimi i privatësisë, sigurisë dhe kufizimit të privilegjeve.

- Të dhënat duhet të jenë primare

Të dhënat duhet të publikohen ashtu siç grumbullohen që në burim, në nivelin më të detajuar të mundshëm, jo në forma të përmbledhura ose të modifikuara.

- Të dhënat duhet të publikohen në kohë

Të dhënat duhet të publikohen sa më shpejt të jetë e mundur, pas mbledhjes së informacioneve dhe detajimit të hollësishëm. Shpejtësia e publikimit mund të sjellë pasaktësi në versionin e parë, prandaj versionet më të sakta duhet të publikohen kur të jenë të disponueshme.

- Të dhënat duhet të jenë të aksesueshme

Të dhënat publike duhet të jenë të disponueshme dhe të lehta për t'u gjetur përmes një pike të vetme aksesi online. Sektori publik ka një mori faqesh të ndryshme, prandaj është e rëndësishme që të ketë një pikë të vetme aksesi, të mirënjohur, ku njerëzit mund të gjejnë të dhënat.

- Të dhënat duhet të jenë të ripërdorshme (reusable)

Vetëm publikimi i të dhënave përfaqëson një pjesë të transparencës. Të dhënat duhet të publikohen në formate që mund të ripërdoren (*reusable*). Organet publike duhet të inkurajojnë në mënyrë aktive ripërdorimin e të dhënave të tyre publike, duke dhënë informacion dhe mbështetje për ta mundësuar atë në mënyrë sa më të lehtë dhe efektive. Qeveria duhet të nxisë ndarjen (*sharing*) e njohurive dhe aplikacioneve dhe duhet të punojë me biznesin

për të ndihmuar në zhvillimin e përdorimeve të reja dhe inovative të të dhënave, për të gjeneruar përfitime ekonomike.

- Të dhënat duhet të jenë të përpunueshme nga makina (*machine-processable)*

Të dhënat duhet të strukturohen në mënyrë të tillë, që të lejojnë përpunimin e automatizuar të tyre. Për të mundësuar ripërdorimin e të dhënave, ato duhet të jenë të përpunueshme-nga-makina (*machine- processable*).

- Aksesi e të dhënat nuk duhet të jetë diskriminues

Të dhënat duhet të jenë të disponueshme për të gjithë, pa asnjë kërkesë për regjistrim.

- Formatet e të dhënave duhet të jenë "pa-pronësi" (*non-proprietary*)

Të dhënat duhet të jenë të disponueshme në formate, mbi të cilat asnjë subjekt nuk ka kontroll ekskluziv.

- Të dhënat duhet të jenë të disponueshme nën një licencë të hapur

Të dhënat duhet të publikohen nën të njëjtën licencë të hapur, e cila mundëson ripërdorim të lirë të të dhënave, duke përfshirë dhe ripërdorimin komercial. Të dhënat nuk duhet të jenë subjekt me të drejta autori, patentë apo markë tregtare. Kufizimet e arsyeshme të privatësisë, sigurisë dhe privilegjeve mund të lejohen, nëse qeverisen nga statute të tjera.

Të dhënat publike duhet të jenë lirisht të disponueshme për t'u përdorur në çdo mënyrë të ligjshme, pa pasur nevojë për regjistrim. Aplikacionet duhet të jetë në gjendje të përdorin të dhënat, pa pasur nevojë për të informuar apo për të marrë lejen e organeve publike të interesuara.

- Të dhënat duhet të publikohen duke përdorur standarde të hapura

Të dhënat publike duhet të publikohen duke përdorur standarde të hapura dhe duke ndjekur rekomandimet përkatëse të Konsorciumit *World Wide Web* (W3C). Formatet e hapura dhe të standardizuara janë thelbësore. Megjithatë për të rritur ripërdorueshmërinë dhe aftësinë për të krahasuar të dhënat, duhet transparencë dhe standardizim si për formatin, ashtu dhe për përmbajtjen e tyre.

- Të dhënat duhet të publikohen në formën *Linked Data.*

Standardet e *Linked Data* lejojnë ripërdorim më të lehtë të të dhënave. Në vend që të vonohet publikimi i të dhënave, rekomandohet që fillimisht të publikohen sa më shpejt të jetë e mundur ashtu "siç janë" dhe më pas të punohet për t'i konvertuar ato në një format më të përshtatshëm.

Politika dhe praktika të të dhënave publike do të nxiten në mënyrë të qartë nga qytetarët dhe bizneset që duan dhe t'i përdorin të dhënat, duke përfshirë se çfarë të dhënash janë publikuar, kur dhe në çfarë forme (ky parim themelor duhet të aplikohet për zbatimin e të gjitha parimeve të tjera). Institucionet publike duhet të ruajnë dhe të publikojnë inventarët e tyre të të dhënave (të sakta dhe të përditësuara), duke përfshirë saktësinë dhe disponueshmërinë e formatit të të dhënave.

Objektivi i katërt: Arritja e një qeverisjeje transparente dhe të përgjegjshme

Objektivi kryesor i implementimit të open data është një qeverisje me eficente dhe efektive, rritje ekonomike dhe inovacion, transparencë dhe përgjegjështmëri, promozimi i ripërdorimit të informacionit publik me duke respektuar të drejtën e pronësisë intelektuale dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Reduktim i procedurave burokratike, reduktim të kostove të administratës publike rritje të shpejtësisë dhe sigurisë në procedurat administrative.

Arritja e këtyre objektivave, ndërthur pa dyshim shumë faktorë dhe aktorë. Realizimi i suksesshëm kërkon një lidership dhe angazhim të qartë nga nivelet e larta drejtuese. Krahas aktiviteteve të përmendura më sipër në nivel sektorial për çdo ministri apo institucion dhe atyre ndërsektoriale një herë në vit do të organizohet një konferencë/forum i nivelit të lartë për të analizuar ecurinë e proceseve për një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme si dhe nivelin e ofrimit të të dhënave të hapura. Komiteti përgjegjës për implementimin e këtij dokumenti do të jetë në udhëheqje të këtij procesi.

Çdo institucion do të paraqesë analizën e bërë mbi impaktin social dhe ekonomik për të dhënat e hapura.

KAPITULLI I KATËRT
IMPLEMENTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i implementimit të këtij dokumenti do të udhëhiqet në nivel vendimmarrje nga Komiteti për Zhvillimin e Shërbimeve Publike (këtu e me poshtë "Komiteti") i kryesuar nga Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe me përbërje të ministrive dhe institucioneve/agjencive të përfshira në të.

Në këtë Komitet do të ftohen të marrin pjesë institucione, agjenci që mbulojnë fusha të caktuara që janë pjesë e rëndësishme e mbledhjes, përpunimit dhe gjenerimit të dhënave publike që duhet të jenë të hapura për publikun. Komiteti do ndjekë në vijimësi procesin e implementimit dhe arritjen e objektivave për zhvillimin e *open data* në Shqiperi.

Nga pikëpamja operacionale do të ngrihet Sekretariati Teknik, me përfaqësues të institucioneve, i cili do të luajë rolin e koordinatorit midis të gjithë aktorëve të përfshirë në zhvillimin e *open data*. Sekretariati teknik do zhvillojë komunikime periodike dhe koordinojë punën me të gjitha institucionet, si dhe do raportojë periodikisht mbi ecurinë e procesit tek Komiteti.

Ministritë, agjencitë do të përcaktojnë personat përgjegjës, të ngarkuar për realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara në këtë dokument.

Ministritë dhe agjencitë përgjegjëse do të bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe sektorin privat. Implementimi i disa aktiviteteve të planin të veprimit mund t'u delegohen organizatave joqeveritare.

Institucionet përgjegjëse për aktivitetet respektive të përcaktuara në këtë dokument do të raportojnë periodikisht pranë Komitetit mbi statusin e realizimit të tyre dhe Sekretariati Teknik do të jetë koordinatori.

Duke u bazuar në këto raportime, si dhe në treguesit statistikor, do të bëhet vlerësimi i progresit drejt arritjeve të objektivave të vendosura. Bashkëlidhur këtij dokumenti paraqitet plani i veprimit afatmesëm për aktivitetet që do ndërmerren me miratimin e këtij dokumenti. Ky plan do jetë subjekt rishikimi periodik.

Treguesit për monitorimin e zhvillimit të *open data* në Shqipëri do të përfshijnë:

- Përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës së qeverisjes;
- Rritjen e indeksit të *e*-pjesëmarrjes;
- Indeksi për *e*-qeverisjen dhe indeksi për e-pjesëmarrjen;
- Numri i vizitorëve;
- Numri i vizitorëve unik;
- Numri i faqeve të vizituara;
- Numri i dokumenteve të shkarkuar.

Të dhëna statistikore nëpërmjet mjeteve të analizës që përdor Google për:

- Numrin e vizitorëve;
- Numri i vizitorëve unik/numri i vizitorëve;
- Numri i faqeve të vizituara;
- Numri i dokumenteve të shkarkuar;
- Indeksi për e-qeverisje nga raporti i UNPAN.

Për monitorimin dhe vlerësimin e impaktit të dhënave të hapura do të hartohet metodologjia e vlerësimit të implementimit të të dhënave të hapura bazuar në praktikat ndërkombëtare. Për zhvillimin e saj do të punohet me INSTAT dhe me shoqërinë civile.

KAPITULLI V
FINANCIMI

Për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë dokument, çdo institucion do të planifikojë në buxhetin vjetor aktivitetet e nevojshme që duhet të mbulojë respektivisht.

Krijimi i portalit www.opendata.gov.al do të realizohet nga AKSHI, e cila ka parashikuar në buxhet zërin përkatës të investimit për portalin *open data*.

Miratimi i këtij dokumenti shënon një hap të rëndësishëm në përmbushjen e angazhimeve për një qeverisje të hapur dhe OGP.

PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Periudha
1.	Krijimi i kuadrit ligjor për të dhënat e hapura: Adoptimi i direktivës për ripërdorimin e informacionit	MIAP/AKSHI	2015
2.	Krijimi i njësisë për implementimin e të dhënave të hapura në çdo institucion sipas një udhëzimi të ministrit përgjegjës	Çdo institucion/Komiteti	2015
3.	Hartimi i një plan të detajuar aktivitetesh për promovimin e përdorimit të të dhënave të hapura sipas institucioneve	Çdo institucion/Komiteti	2015
4.	Vlerësim i sistemeve ekzistuese të informacionit dhe analizimi i aftësive të tyre për të prodhuar të dhëna sipas formatit të të dhënave të hapura.	AKSHI/ çdo institucion	2015
5.	Krijimi/zhvillimi i portalit të të dhënave të hapura/publike www.open.da.gov.al që do të shërbejë si pikë e integruar e aksesit	AKSHI	2015
6.	Identifikimi i listës së të dhënave që publikojnë aktualisht çdo institucion dhe të dhënave me interes që nuk publikohen. Identifikimi i problemeve të lidhura me pronësisë intelektuale apo të dhënat personale në rast ripërdorimit të tyre me qëllim nxitjen e rritjes ekonomike nga këto të dhëna.	Çdo institucion/Komiteti	2015
7.	Krijimi i inventarit të të dhënave qeveritare që do jenë pjesë e portalit *open data*	Komiteti/çdo institucion	2015-2016
8.	Zhvillimi i seminareve për standardet e të dhënave të hapura – njohja me rregulloren për standardet e formatit *open data* të përcaktua në rregullore e miratuar nga AKSHI.	MIAP/ASPA/AKSHI	2015-2016
9.	Të dhëna të hapura/publike të disponueshme mbi legjislacionin dhe projekt aktet në formatin *open data*	QBZ/çdo institucion/ Komiteti	2015-2016
10.	Të dhëna të hapura/ publike të disponueshme për buxhetin dhe shpenzimet buxhetore/qeveritare në formatin *open data*	MF/AKSHI	2015
11.	Të dhëna të hapura/ publike të disponueshme për statistikat në formatin *open data*	INSTAT/AKSHI	2015-2016
12.	Të dhëna të hapura të disponueshme për publikun për regjistrimin e biznesit në formatin *open data*	QKR/AKSHI	2015-2016
13.	Të dhëna të hapura të disponueshme për publikun mbi performancën në sistemin arsimor të nivelit të parë dhe të dytë në formatin open data	MAS/AKSHI/INSTAT	2015-2016
14.	Të dhëna të hapura të disponueshme për publikun mbi performancën në sistemin shëndetësor, në formatin *open data*	MASH/INSTAT/AKSHI	2015-2016
15.	Trajnime për stafin IT dhe jo IT të administratës publike për *open data* shkëmbim i eksperiencave të mira.	AKSHI/ASPA	2015-2016
16.	Aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit mbi përdorimin e lirë, ripërdorimin, linkun dhe rishpërndarja e të dhënave mbi informacionin për publikun për qëllime tregtare ose jotregtare: konferenca, takime me shoqërinë civile grupe të tjera të interesit	MIAP/Komiteti	2015-2016
17.	Bashkëpunim me autoritetet vendore për të identifikuar bashkësinë e të dhënave që duhet të jenë të hapura për publikun dhe rritje të transparencës.	Komiteti / Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	2016
18.	Krijimi i një Bordi/Forumi i Transparencës Publike – me përfaqësuesit e çdo institucioni dhe shoqëri	Komiteti	2015

	civile për ndjekjen e impaktit të të dhënave që do publikohen në *open data portal*.		
19.	Të dhëna të hapura/ publike mbi HARTËN të disponueshme (krijimi i Gjeoportalit)	ASIG/MIAP	2015
20.	Të dhëna të hapura/publike mbi pronësinë mbi tokën, të disponueshme në formatin *open data*	ZRPP/AKSHI/AKKP/Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave Ndërtimore Informale	
21.	Të dhëna të hapura për statistikat mbi krimin, të disponueshme në formatin *open data*	MB/MD/AKSHI	2015-2016
22.	Zhvillimi i metodologjisë së vlerësimit të *open data implementation*	MIAP/INSTAT/AKSHI	2015
23.	Aktivitete për rritje të cilësisë së të dhënave të hapura.	MIAP/AKSHI/INSTAT	2015-2016

VENDIM
Nr. 149, datë 18.2.2015

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, pika 5, e 75, pika 3, të ligjit nr. 70/2014, "Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme", të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit operacional me grada, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në vijim, Shërbimi, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore për gradë, e përcaktuar në kolonën 3, të lidhjes nr. 1, është niveli i pagës së punonjësit operacional, në përputhje me gradën që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi, e përcaktuar në kolonën 4, të lidhjes nr. 1, jepet sipas funksioneve të përcaktuara në këtë lidhje.

4. Punonjësit operacionalë me grada, përfitojnë shtesë për vjetërsi, përfshirë dhe kohën e qëndrimit në gradë në institucionet që funksionojnë me sistemin me grada, në masën 1 % për çdo vit pune. Masa e shtesës për vjetërsi plus pagën për gradë nuk duhet ta kalojë nivelin e pagës së gradës pasardhëse.

5. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit pa grada dhe mbështetës janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Kategoria e pagës për punonjësit e Shërbimit pa grada dhe mbështetës përcaktohet sipas kolonës 3, të lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Paga e grupit (paga për nivelin arsimor të kërkuar për vendin e punës) përcaktohet sipas kolonës 4, të lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Vlera e pagës për çdo grup të diplomave të arsimit universitar është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Punonjësi i personelit pa grada dhe mbështetës i Shërbimit përfiton shtesë për vjetërsi në punë në masën 2 %, për çdo vit, por jo më shumë se 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

10. Shtesa për pozicion, për punonjësit pa grada dhe mbështetës të Shërbimit, përcaktohet sipas kolonës 6, të lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi, për punonjësit pa grada dhe mbështetës të Shërbimit, përcaktohet sipas kolonës 7, të lidhjes nr. 2, dhe aplikohet sipas funksioneve të përcaktuara në këtë lidhje.

12. Punonjësit e Shërbimit, pa grada, të cilët punojnë në sektorin e përgjimit dhe zyrën e kartotekës, përfitojnë shtesë për punë në kushte të vështira dhe të dëmshme për shëndetin, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin përkatës të pagave të punonjësve mbështetës dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore.

13. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Punëve të Brendshme për vitin 2015.

14. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1 janari i vitit 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT OPERACIONAL, ME GRADA TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

Nr.	Grada	Funksionet organike	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4
1	Asistent	Ndihmës specialist në provë në trupën operacionale	44,500	9,000
2	Asistent i parë	Ndihmës specialist në trupën operacionale	49,000	9,000
3	Kryeasistent	Drejtues grupi/ ndihmës specialist në trupën operacionale	54,500	9,000
4	Inspektor	Specialist në nivel vendor Specialist i trupës operacionale	65,000	8,000
5	Inspektor i Parë	Specialist në nivel vendor Specialist në nivel qendror në trupën operacionale	77,000	8,000
6	Kryeinspektor	Shef sektori në nivel vendor Specialist në nivel qendror	82,000	10,000
7	Drejtues i Shërbimit	Shef sektori në nivel qendror Specialist në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor	88,000	10,000
8	Drejtues i Parë i Shërbimit	Drejtor drejtorie në nivel qendror Shef sektori në nivel qendror Drejtor drejtorie në nivel vendor	99,000	10,000
9	Zv/Drejtor i Përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	102,000	17,000
10	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	111,000	22,000

Lidhja nr. 2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT PA GRADA DHE MBËSHTETËS TË SHËRBIMIT							
Nr.	**Klasifikimi i niveleve**	**Funksionet organike**	**Kategoria e pagës (prozohet)**	**Paga e grupit**	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa e pozicionit (propozohet)**	**Shtesa për natyrë të veçantë pune (propozohet)**
	1	2	3	4	5	6	7
1	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit	II-b	1	2%	91,700	
		Drejtor në nivel qendror (shërbimet mbështetëse)	III-a	1	2%	74,400	
2	Punonjës të nivelit të ulët drejtues	Shef sektori në nivel qendror (në drejtorinë e inspektimit dhe në sektorin operacional)	III-a/1	1	2%	65,200	14,000
		Shef sektori në nivel qendror (në drejtorinë e shërbimeve mbështetëse)	III-a/1	1	2%	65,200	
3	Punonjës të nivelit ekzekutiv	Specialist (në sektorin operacional)	III-b	1	2%	57,000	10,000
		Specialist (drejtorinë e inspektimit)	III-b	1	2%	57,000	5,000
		Specialist në nivel qendror	III-b	1	2%	57,000	
			IV-a	1 ose 2	2%	45,800	
			IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	35,500	

Lidhja nr. 3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	**Lloji i diplomës**	**Vlera**
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master Profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

UDHËZIM
Nr. 1, datë 18.2.2015

PËR MËNYRËN E MARRJES NË DORËZIM TË MALLRAVE NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, "Për rezervat materiale të shtetit", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. Marrja në dorëzim e mallrave nga blerjet me fondet buxhetore

1. Çdo hyrje e mallrave në magazinë dokumentohet menjëherë. Mallrat, që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së mallrave, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.

2. Magazinieri dorëzon te nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletëhyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit), fletëdaljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë.

3. Në raste të caktuara, sipas nevojave të njësisë publike, bëhet dërgimi i mallrave drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi te

përdoruesi (p.sh., direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (p.sh., në magazinën qendrore të njësisë publike). Në këtë rast, duhet të miratohen nga drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Veprimet bëhen në prani të magazinierit të ngarkuar me përgjegjësinë materiale të mallrave.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni përbëhet nga jo më pak se tre specialistë të fushës, sipas llojit të mallrave, dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm.

5. Marrja në dorëzim e mallrave bëhet në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe në varësi të ambalazhimit të tyre, në këtë mënyrë:

a) Kur sasia e mallrave matet me anë të peshimit, verifikimi i sasisë bëhet duke zbritur nga pesha bruto peshën e ambalazhit ose duke peshuar vlerat materiale që gjenden brenda ambalazhit, sipas natyrës së tij.

b) Llogaritja e peshës së ambalazhit bëhet sipas shënimeve të vëna nga furnizuesi mbi secilën pako, duke bërë, në rast nevoje, prova verifikimi me zgjedhje, me anën e peshimit të ambalazhit të zbrazur. Kur nga verifikimi i tij del se ka diferencë ndërmjet peshës së tij faktike dhe shënimeve të vëna nga shitësi, bëhet peshimi i gjithë ambalazhit. Kështu veprohet edhe për aktivet e vendosura në ambalazh të hapur.

c) Kur në ambalazhin standard e me shenjën e fabrikës (prodhuesit), nga verifikimi me zgjedhje duke peshuar jo më pak se 10 për qind të të gjithë sasisë së ambalazhit, dalin diferenca, verifikimi shtrihet në të gjithë sasinë.

ç) Verifikimi i sasisë brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën, bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtme të paketuara standarde, merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë prova me zgjedhje, dhe, kur ka diferenca, verifikimi bëhet për gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një.

6. Kur ka mospërputhje ndërmjet sasive të mallrave të shënuara në fletëdalje, në faturat ose në dokumentet e tjera shoqëruese dhe sasive efektive që gjenden brenda ambalazhit, si dhe në cilësi, llojshmëri, qenien e plotë dhe markën e prodhimit, komisioni ndërpret verifikimin dhe lajmëron shitësin (furnizuesin) që të paraqitet brenda një afati kohor të përcaktuar (në varësi të vendndodhjes, brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike në marrëdhënie me furnitorin).

7. Kur shitësi nuk paraqitet brenda afatit për të parë gjendjen dhe për t'i dhënë rrugë veprimit, komisioni vazhdon verifikimin rregullisht. Verifikimi nuk ndërpritet kur mospërputhjet mund të provohen edhe në mbarim të verifikimit.

8. Në çdo rast komisioni mban një proces-verbal për sasinë e mallrave, në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës; nuk i merr në dorëzim, por i mban në ruajtje në po ato kushte që mban mallrat e veta dhe njofton shitësin (furnizuesin) për t'i tërhequr, duke përcaktuar dhe afatin kohor, sipas rastit (brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike në marrëdhënie me furnitorin).

9. Kur shitësi nuk paraqitet brenda afatit të lajmëruar nga blerësi dhe aktivet prishen shpejt e, për pasojë, nuk mund të vihen në ruajtje, blerësi harton procesverbal, me komision prej jo më pak se tre personash, për diferencat, dëmtimet, apo ndryshimin e cilësisë. Aktivet në gjendje të përdorshme i vë në përdorim, për diferencat në sasi apo çmim përgjegjësia bie mbi shitësin.

10. Bëhet kontrolli i artikujve sipas sasisë dhe çmimit (sasia dhe çmimi që ka fatura e furnitorit që bën dalje aktivet duhet të jenë të njëjta me ato të regjistruara nga magazinieri në fletëhyrje), kryhen shumëzimet dhe nxirret vlera totale e fletëhyrjes.

11. Bëhet regjistrimi i dokumenteve në librat e kontabilitetit dhe kartelat e aktiveve, jo më vonë se dita e nesërme e paraqitjes së tyre. Në dokument shënohet numri i faqes së librit dhe si fraksion numri rendor që ka marrë regjistrimi i kryer. Në fund të çdo muaji dokumentet e regjistruara vendosen në dosjen përkatëse.

12. Mallrat e marra në ruajtje dokumentohen menjëherë me fletëhyrjen që përmban shënimin "Mallra në ruajtje".

13. Procesverbali i drejtohet nëpunësit zbatues të njësisë për informacion dhe për ndjekje, sipas dispozitave në fuqi, në rastet e nevojshme.

14. Shpenzimet e transportit deri në depot apo magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit përballohen nga furnizuesi apo organi që dorëzon mallin.

15. Drejtoritë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, strukturat e nëpunësit zbatues (specialisti i financës, përgjegjës për administrimin e dokumentacionit të magazinave), para marrjes në dorëzim të dokumenteve nga personat me përgjegjësi materiale (magazinierët), kryejnë kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikëpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.

16. Kontrollohet numri rendor i dokumentit, si për fletëhyrje dhe për fletëdalje, i cili duhet të ndjekë rendin kronologjik dhe të mos ketë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jokronologjike, nëpunësi zbatues i Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit (specialisti i financës, përgjegjës për administrimin e dokumentacionit të magazinave) mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon çdo parregullsi te drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit.

17. Strukturat përgjegjëse për financat (specialisti i financës, përgjegjës për administrimin e dokumentacionit të magazinave) duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës, si: procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletëhyrje origjinale, procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit etj.

II. Marrja në dorëzim e mallrave nga të tretët nëpërmjet transferimit pa pagesë dhe/apo mallrave të dhuruara

1. Për marrjen në dorëzim të mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletëhyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës, si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese dorëzuese që ka bërë dalje malli, shkresën e njësisë për transferimin e mallrave, shkresën për pranim malli të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit.

2. Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit i përcjell aktkonfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pasardhës. Aktkonfirmimi firmoset nga drejtori Rajonal i Rezervave Materiale të Shtetit dhe nëpunësi zbatues, i cili vërteton përfundimin e transaksionit.

3. Për marrjen në dorëzim të mallrave të dhuruara (ndihmë humanitare) dokumentacioni shoqërues përbëhet nga marrëveshja/akti i dhurimit ose letra zyrtare e donatorit, fatura që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre, dokumentet e zhdoganimit dhe certifikata e origjinës (në rast importi), si dhe procesverbali i marrjes në dorëzim, i konfirmuar nga drejtori rajonal i Rezervave Materiale të Shtetit.

4. Në rastet kur dhurimet në natyrë të mallrave nga donatorë të ndryshëm jepen vetëm në sasi (pa çmim apo kosto), ato pranohen nga Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit dhe drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit autorizon vlerësimin e tyre. Vlerësimi për efekt magazinimi bëhet me çmimin dysheme që zbatohet në llogaritjen e taksave doganore. Për mallrat për të cilat nuk ka çmime dysheme të miratuara, vlerësimi do të bëhet sipas koniunkturave të tregut të brendshëm.

5. Ndihmat humanitare ushqimore, mjekësore etj. do të merren në dorëzim sipas certifikatës së cilësisë së mallit. Ato nuk duhet të jenë nën nivelin e standardeve të detyrueshme shqiptare. Në rast dyshimi, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit kërkon konfirmimin e organeve të standardizimit e të cilësisë për kontrollin e garancisë së cilësisë dhe sigurisë së përmbushjes së standardeve në fuqi.

6. Dhuruesit marrin përsipër dhe përgjigjen për kthimin ose asgjësimin, për llogari të tyre, të ndihmave jashtë standardeve të detyrueshme.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit mund t'u kalojë në përdorim, pa shpërblim dhe me afat deri në dy muaj, dy magazina dhuruesve, sipas vëllimit të ndihmave për emergjencë që ata sjellin. Drejtoria e

Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit lidh me dhuruesit kontratat përkatëse për përdorimin e këtyre magazinave. Afatet e kontratave mund të zgjaten tej afatit të mësipërm, në varësi nga vëllimi i ndihmave që sjellin dhuruesit. Sigurimi i magazinave të dhuruesve bëhet nga vetë dhuruesit me roja të armatosura, në përputhje me kuadrin ligjor për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike.

III. Marrja në dorëzim e mallrave që kalojnë në favor të shtetit si pasojë e konfiskimit për shkak të kundërvajtjeve administrative apo të kryerjes së veprave penale

1. Mallrat/sendet e konfiskuara si pasojë e kundërvajtjes administrative apo kryerjes së veprës penale merren në dorëzim dhe magazinohen nga drejtoritë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, vetëm kur vendimi i konfiskimit dhe kalimit në favor të shtetit, i organit të ngarkuar me ligj, ka marrë formë të prerë.

2. Merren në dorëzim dhe magazinohen nga drejtoritë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit edhe mallrat/sendet e sekuestruara, konfiskuara, subjekteve debitore si pasojë e vjedhjes me forcë nga ana e institucioneve publike të detyrimeve të pashlyera.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave që kalojnë në favor të shtetit si pasojë e konfiskimit për shkak të kundërvajtjeve administrative apo kryerjes së veprave penale, për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni përbëhet nga jo më pak se tre specialistë të fushës, sipas llojit të mallrave, dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm.

4. Komisioni, në praninë e përgjegjësit të bazës materiale, bën marrjen në dorëzim sipas aktit administrativ apo vendimit të formës së prerë, të organit të ngarkuar me ligj për konfiskimin, verifikimit faktik të mallrave/sendeve, dokumentacionit shoqërues të mallit, si: fatura e mallit, certifikata e origjinës dhe cilësisë, aktit të çmimit të mallrave/sendeve nga organi përkatës dorëzues.

Për këtë rast, pas verifikimit paraprak të mallrave, hartohet procesverbali i përbashkët midis përfaqësuesit e organit dorëzues dhe Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, duke argumentuar arsyet:

a) nëse mallrat janë të nevojshëm apo jo për veprimtarinë e DPRMSH-së;

b) nëse nuk rezultojnë të nevojshme për DPRMSH-në, a janë në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera;

c) nëse duhet të nxirren përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturinë (skrap) apo asgjësimit përfundimtar.

Nëse, pas verifikimit, mallrat rezultojnë pa vlera përdorimi dhe konkludohet për asgjësimin e tyre përfundimtar, ato nuk merren në dorëzim nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

5. Kur mallrat/sendet janë jashtë mundësive të magazinimit apo transportimit në ambientet magazinuese të Rezervave Materiale të Shtetit, si: prodhime ari, argjendi, platini, mjete lundrimi, mallra të ndryshëm tepër vëllimorë; ose të tilla që me kalimin e kohës mund të ndryshojnë natyrë apo të bëhen të rrezikshme për shëndetin, si: fruta, perime, zarzavate, bulmet, mish dhe çdo mall i kësaj natyre, që kërkojnë kushte të veçanta mirëmbajtjeje, magazinohen pranë agjentëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kushtet teknike të nevojshme dhe të domosdoshme për të siguruar pandryshueshmërinë e gjendjes cilësore dhe vëllimore të tyre. Kontraktimi me agjentë ekonomikë realizohet rast pas rasti nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

6. Evidencimi për marrjen në dorëzim të mallrave/sendeve të kaluara në favor të shtetit si pasojë e konfiskimit për shkak të kundërvajtjeve administrative apo kryerjes së veprave penale, realizohet nëpërmjet regjistrimit në një rubrikë të veçantë të grup-mallrave Rezervë Materiale Shtetërore, me emërtim "Mallra – sende nga kundërvajtjet administrative dhe kryerja e veprave penale", e cila ndahet analitikisht në varësi të natyrës dhe llojshmërisë. Mallrat/sendet e kaluara në favor të shtetit si pasojë e konfiskimit për shkak të kundërvajtjeve administrative apo kryerjes së veprave penale, të cilat rezultojnë jashtë përdorimit, nuk merren në dorëzim nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

7. Kur këto mallra/sende kanë në përbërje të tyre inventar të imët të gjithfarëllojshëm, evidencohen, detyrimisht, duke pasqyruar saktë

me emërtim dhe sasi çdo gjë që përbën objekt inventari.

8. Mallrat/sendet e kaluara në favor të shtetit si pasojë e konfiskimit për shkak të kundërvajtjeve administrative apo kryerjes së veprave penale, vijojnë të kontabilizohen, rast pas rasti, si më poshtë:

a) Në rast se mallrat/sendet dorëzohen me aktin e çmimeve nga organi përkatës, kjo është vlera që do të shërbejë për kontabilizimin e tyre;

b) Në rastin kur mungon akti i çmimit të mallrave/sendeve nga organi përkatës dhe është miratuar tjetërsimi i tyre nëpërmjet shitjes, atëherë si vlerë kontabilizuese do të shërbejë vlera e pasqyruar në faturën e TVSH-së, që lëshohet për blerësin publik, në përfundim të procedurave të ankandit publik;

c) Në rast se, ndër të tjera, përcaktohet plotësimi i sasisë së mallrave rezervë materiale shtetërore me mallra/sende të përmendura në pikën 1, të këtij neni, si vlerë kontabilizuese do të shërbejë vlera e këtyre mallrave që do të rezultojë nga testimi i tregut të brendshëm.

9. Mallrat e marra në ruajtje për llogari të organeve proceduese dokumentohen menjëherë sipas përcaktimeve të aktit për lënien në ruajtje, me fletëhyrjen që përmban shënimin "Mallra në ruajtje".

10. Shpenzimet e transportit deri në depot apo magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit përballohen nga institucioni apo organi që dorëzon mallin.

IV. Zbatimi i afatit të përdorimit

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk merr në dorëzim mallra të skaduar ose në prag të skadimit. Lejohet të merren në dorëzim produkte ushqimore, të kategorisë "Ushqime që prishen shpejt", me afat garancie jo më pak se 1/3 e kohës së deklaruar të përdorimit të tyre, ndërsa produktet ushqimore me afat përdorimi të gjatë lejohen të merren në dorëzim brenda jo më pak se 6 (gjashtë) muajve të fundit të afatit të garancisë.

V. Procesi i administrimit (inventarizimi, vlerësimi, tjetërsimi apo nxjerrja jashtë përdorimit)

1. Procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të mallrave realizohet nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit, ndërsa procesi i tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave kryhet nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit, me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit. Në të gjitha rastet komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të mallrave ka përbërje tjetër nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi të mallrave.

2. Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përgjigjen për zbatimin e ligjshmërisë për inventarizimin, vlerësimin dhe për nxjerrjen nga përdorimi të mallrave.

3. Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona, të cilët janë menaxherë ose specialistë të financës, si dhe specialistë të fushës përkatëse, sipas natyrës së mallrave që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është nëpunësi zbatues i njësisë. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit. Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë.

4. Nëpunësi zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të mallrave të rezultuar nga inventarizimi, normës së përdorimit/amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, përcakton gjendjen faktike të mallrave dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit dhe përgjegjësi material. Ajo hartohet në tri kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv.

5. Vlerësimi i mallrave bëhet sipas këtyre kritereve:

a) kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, përdorimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;

b) kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;

c) kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit;

ç) kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm;

d) kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;

dh) kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;

e) kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmbytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;

ë) kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të institucionit, objektivave afatmesëm ose afatgjatë nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.

6. Procesverbali i vlerësimit hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha mallrave, duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre:

a) nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e Rezervave Materiale të Shtetit;

b) nëse nuk rezulton i nevojshëm për Rezervat Materiale të Shtetit, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera;

c) nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar.

Procesverbali hartohet në tri kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Procesverbali miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit.

7. Relacioni i vlerësimit përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e mallrave për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tri kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit.

8. Aktivet afatgjata të cilat, pas vlerësimit, mbeten në gjendje përdorimi, mund të jepen në përdorim të përkohshëm në rend shterues:

a) brenda njësisë publike (nga qendra në njësi shpenzuese dhe anasjelltas);

b) pa pagesë, në njësi të tjera jashtë sektorit të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Aktivet afatgjata të cilat, pas vlerësimit, mbeten në gjendje përdorimi dhe që konsiderohen të panevojshme për Rezervat Materiale të Shtetit mund të jepen në rend shterues (nga a në b):

a) transferohen, pa pagesë, në një njësi tjetër publike brenda sektorit të qeverisjes së përgjithshme. Konfirmimi zyrtar nga njësia përfituese vërteton përfundimin e transaksionit;

b) shiten, me ankand publik, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

9. Aktivet të cilat, pas vlerësimit, nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si mbeturina/materiale të ricikluesshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe shiten me ankand (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi, duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur. Procesverbali për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve hartohet nga komisioni për nxjerrjen nga përdorimi, në tri kopje, ku përshkruhet procedura e ndjekur, sipas rastit, për çdo aktiv, lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, apo nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

VI. Hyrja në fuqi dhe zbatimi

1. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë